


RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave
mbeshtetese ne Gjirokaster



Dea Studio
MVM Architecture

Tiranë, Tetor 2020

TABELA E PERMBAJTJES

SHPJEGUESIT E SHKURTIMEVE	5
1. HYRJE	6
2. BAZA LIGJORE, METODOLOGJIA DHE AUTORITETET PERGJEGJESE.....	8
2.1. BAZA LIGJORE	8
2.2. METODOLOGJIA	9
2.3. AUTORITETET PERGJEGJESE	10
3. PERSHKRIMI I ZONES SE PROJEKTIT	12
3.1. GJENDJA EKZISTUESE E ZONES SE PROJEKTIT	12
3.2. HABITATI DHE BIODIVERSITETI I ZONES NE STUDIM	13
3.3. PEISAZHI I SHESHIT	13
4. PERSHKRIMI I PROJEKTIT	14
4.1. OBJEKTIVAT	14
4.2. ANALIZA E DIZAJNIT	16
4.3. KONCEPTI I PARKIMIT NENTOKESOR	21
5. NDIKIMET NE MJEDIS	24
5.2. MJEDISI SOCIAL-EKONOMIK	24
5.2.1. Demografia	24
5.2.2. Ndikimi gjatë fazës së zbatimit të projektit në komunitet	26
5.2.3. Masat korrigjuese/zbutëse	26
5.2.4. Ndikimi gjatë fazës së funksionimit në komunitet	27
5.3. TRASHEGIMIA KULTURORE.....	28
5.4. MJEDISI FIZIK	29
5.4.1. Klima	29
5.4.2. Cilësia dhe Pastërtia e Ajrit.....	30
5.4.3. Ndikimi në cilësinë e ajrit gjatë fazës së zbatimit të projektit	30
5.4.4. Masat zbutëse/korrigjuese për ruajtjen e cilësisë së ajrit.....	31
5.4.5. Ndryshimet e klimës	31
5.5. GJEOMORFOLOGJIA, GJELOGJIA DHE TOKAT	33
5.5.1. Gjeomorfologjia dhe Gjeologjia.....	33
5.5.2. Tokat	33
5.5.3. Ndikimi gjatë fazës së zbatimit të projektit, dherat dhe masat zbutëse/korrigjuese	35
5.6. HIDROLOGJIA, UJRAT NËNTOKËSORE, SIPËRFAQËSORE DHE TRUPAT UJORE.....	35
5.6.1. Hidrologjia	35

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne
Gjirokaster

5.6.2.	Ndikimet gjatë fazës së zbatimit të projektit për hidrologjinë.....	36
5.6.3.	Masat zbutëse/korrigjuese për ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore	36
5.7.	NDOTJA AKUSTIKE (ZHURMAT)	36
5.7.1.	Ndikimet dhe masat zbutëse/korrigjuese ndaj zhurmëve	37
5.8.	RREZIQET NATYRORE	37
5.8.1.	Sizmiteti	37
5.8.2.	Rrëshqitjet e dherave dhe përmbytjet	38
5.9.	MJEDISI BIOLOGJIK.....	38
5.9.1.	Flora dhe fauna	38
5.9.2.	Ndikimi mbi florën, faunën dhe biodiversitetit	39
6.	MONITORIMI.....	39
7.	REKOMANDIME TE PERGJITHSHME	40
7.2.	REKOMANDIME PER TOKEN DHE SIZMITETIN	40
7.3.	REKOMANDIME PËR RUAJTJEN E CILËSISË SË AJRIT	40
7.4.	REKOMANDIME PËR UJËRAT SIPËRFAQËSORE/NËNTOKËSORE.....	41
7.5.	REKOMANDIME NGA ZHURMAT	41
7.6.	REKOMANDIME NGA MBETJET	41
8.	BIBLIOGRAFIA.....	42

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1-** Vizualizim nga sheshi pas implementimit të projektit (burimi: Projektuesi)
- Figura 2-** Vizualizim nga hotel Çajupi pas implementimit të projektit (burimi: Projektuesi)
- Figura 3-** Kufinjtë e zonës së propozuar të projektit (burimi: Projektuesi)
- Figura 4-** Foto panoramë nga sheshi ekzistues i Çerçiz Topullit (burimi: Eksperti)
- Figura 5-** Foto nga sheshi ekzistues me fokus bustin e Çerçiz Topullit (burimi: Eksperti)
- Figura 6-** Foto nga pjesa hyrëse e sheshit Çerçiz Topullit (burimi: Eksperti)
- Figura 7-** Seksion tërthor dhe gjatësor i sheshit ekzistues të Çerçiz Topullit (burimi: Eksperti)
- Figura 8-** Propozimi i ruajtjes së harqeve karakteristike me ngjyrë gri dhe elementëve tradicionalë të Gjirokastrës dhe shfaqja e tyre te muri i ri kufizues i parkimit. (burimi: Eksperti)
- Figura 9-** Diagrama e lëvizshmërisë së sheshit Çerçi Topulli. Propozimi i hyrjes së Parkimit Nëntokësor. (burimi: Eksperti)
- Figura 10-** Pozicioni i vendosjes së parkimit nëntokësor të propozuar. (burimi: Eksperti)
- Figura 11-** Seksion tërthor i parkimit nëntokësor të propozuar. Ruajtja e distancës së sigurisë prej 5 metra nga hoteli ekzistues (burimi: Eksperti)
- Figura 12-** Seksion gjatësor i parkimit nëntokësor të propozuar. Ruajtja e pjerrësisë ekzistuese të sheshit. (burimi: Eksperti)
- Figura 13-** Planimetri e parkimit nëntokësor. (burimi: Eksperti)
- Figura 14-** Pamje e parkimit nëntokësor dhe arkadave nga sheshi përballë Shpisë së Pioneerëve. (burimi: Eksperti)
- Figura 15-** Pamje e shkallareve që lidhin sheshin Çerçiz me sheshin pranë shtëpisë së Pioneerëve dhe kabinës elektrike poshtë tyre. Detaj gjelbërimi dhe ndriçimi i propozuar. (burimi: Eksperti)
- Figura 16-** Harta me zonat dhe nënzonat klimatike e Shqipërisë
(Burimi : Banka Botërore dhe UNDP, 2012)
- Figura 17-** Projektimi në përqindje i ndryshimit të indeksit të defiçitit ujor për 2030
(Burimi: Banka Botërore)

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Popullsia rezidente, ndërtimet për qëllime banimi dhe banesat sipas bashkisë/komunës dhe llojit të banesave (burimi: PPV Gjirokastër)

Tabela 2: Ndryshimi i popullsisë ndërmjet viteve 1989-2011 (burimi: PPV Gjirokastër)

Tabela 3: Dendësia e popullsisë në nivel ish njësie administrative (burimi: PPV Gjirokastër)

Tabela 4: Ndikimet në socio-ekonomi

Tabela 5: Shpërndarja e emetimeve të dioksidit të karbonit për çdo njësi administrative në Bashkinë Gjirokastër (burimi: PPV Gjirokastër)

Tabela 6: Ndikimet dhe masat zbutëse/korrigjuese kryesore në drejtim të cilësisë së ajrit

Tabela 7: Klasifikimi i tokës bujqësore në bazë të VKM nr. 703 datë 1995/12/18 dhe Direktiva e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit nr.1, datë 1995/12/29

Tabela 8: Ndikimet dhe masat zbutëse për gjeologjinë dhe dherat

Tabela 9: Ndikimet dhe masat zbutëse/korrigjuese për Hidrologjinë gjatë zbatimit të projektit

Tabela 10: Tabela e listave të parametrave të dhjetë zonave të burimeve sizmike të Shqipërisë. (burimi: DISS)

SHPJEGUESIT E SHKURTIMEVE

AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
GIS	Sistemi Gjeografik i Informacionit
KE	Këshilli i Evropës
KKE	Komisioni i Këshillit të Evropës
ME	Mjedisi Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikës- Republika e Shqipërisë
NGO	Organizata Jo-Qeveritare
OSHE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PMP	Plan i Menaxhimit të Pyjeve
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor (i Bashkisë Gjirokastër)
SNM (NES)	Strategjia Ndersektorale e Mjedisit
SKZHT	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësim Strategjik Mjedisor
VKM	Vendim Këshillit të Ministrisë
ZM	Zonat e Mbrojtura
UKGJ	Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër
WSSD	Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm
PKMM	Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve

1. HYRJE

“Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është një proces i cili kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis si pasojë e zbatimit të projekteve të propozuara publike dhe private. Përmes këtij procesi bëhet e mundur evidentimi, parashikimi dhe vlerësimi i efekteve gjatë dhe pas zbatimit të projektit mbi biodiversitetin, burimet ujore, trupat ujorë, ndikimet në cilësinë e mjedisit (zhurmat, cilësia e ajrit), ndikimet në terren, peisazhin si dhe ndikimin e tërësisë së këtyre faktorëve mbi trashëgiminë kulturore, njerëzit, shëndetin publik si dhe në aspektin ekonomik. Parimi mbi të cilin bazohet hartimi i VNM-së është *“më mirë të parandalosh sesa të riparosh më pas”*. VNM-ja mundëson parandalimin e efekteve negative, i jep përparësi ndikimeve pozitive duke mos lejuar dhe duke shmangur që në etapat e para të zbatimit ndikimet negative.

Në procesin e VNM marrin pjesë zhvilluesi i projektit së bashku me grupin e tij të specialistëve, specialistët e mjedisit, ministria dhe strukturat e saj të varësisë, njësia e qeverisjes vendore në territorin e të cilës zbatohet projekti, grupet e interesit dhe palët e interesuara, publiku dhe organizatat jofitimprurëse përmes ankesave dhe seancave dëgjimore, institucionet që në bazë të ligjit kanë përgjegjësi të përfshihen në procesin e VNM-së si dhe në rastet kur projekti ka kontekst ndërkufitar zbatohen kërkesat sipas Konventës së ESPOO-s.

Përgatitja e këtij raporti paraprak të vlerësimit mjedisor është bërë duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gjirokastrë, ku në këtë plan zona në fjalë e studimit është e shpallur zonë e mbrojtur nga Unesco dhe gjithashtu sipas VKM Nr.619 datë 07.07.2015 “Për shpalljen “Qendër Historike” të një zone në qytetin e Gjirokastrës dhe miratimin e rregullores “Për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur në qytetin e Gjirokastrës”.

Zona e studimit shtrihet sipas PPV së Bashkisë Gjirokastrë në njësitë strukturore ZU.1.A dhe ZU.1.B të cilat bëjnë pjesë në Qendrën Historike të qytetit të Gjirokastrës, me përdorime të lejuara të caktuara nga VKM Nr. 619 e cituar dhe më sipër. Përdorimet e lejuara përfshijnë: S.Shërbime, IS.Institucione, IE.Industri dhe ekonomi, AR.Aktivitete sociale dhe rekreative, AS.Arsim, SH.Shëndetësi. Përdorimet e ndaluara përfshijnë: Ndalohen të gjitha përdorimet që nuk janë në përputhje me ato më sipër.

Konsulenti e ka përshtatur Raportin në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit si dhe ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Hartimi i këtij dokumenti është zhvilluar në përputhje me Ligjin nr. 10440 datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar më Ligj 12/2015.

Baza ligjore e hartimit të VNM-së është ligji nr.10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, si dhe VKM nr.912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

Baza ligjore e mësipërme është mbështetur në Direktivën e BE 85/337/EEC për vlerësimin e efekteve të disa projekteve private dhe publike për mjedisin të modifikuar nga

Direktiva e Këshillit me nr. 97/11/EC, në Direktivën 2003/35/EC, e cila mundëson Pjesëmarrjen Publike, si dhe të Direktivës së Këshillit 96/61/EC që rrjedhin nga konventa e Aarhus-it.

Procesi i hartimit të VNM-së paraprake ka ndjekur disa etapa.

- Së pari është kryer përshkrimi i projektit dhe i zonës lidhur me faktin e nevojës për një VNM paraprake.
- Së dyti është bërë një vlerësim dhe përshkrimi bazë i zonës në të cilën do të zbatohet përpara se projekti të fillojë nga zbatimi, i cili shërben si referencë lidhur me ndryshimet që do të pësojë zona si rezultat i zbatimit të projektit duke bërë të mundur krahasimin midis tyre.
- Së treti është realizuar skanimi i zonës për të identifikuar impaktet e mundshme mbi biodiversitetin dhe jo vetëm (bazuar në kërkesat e ligjit dhe të dokumentave zyrtare) si dhe hartimin dhe gjetjen e zgjidhjeve alternative dhe këshillave për shmangien, zbutjen apo kompensimin e tyre.
- Së katërti është bërë vlerësimi i impakteve të projektit dhe u zhvilluan e u vlerësuan alternativat për zbutjen/korrigjimin impakteve negative.
- Së pesti janë dhënë zgjidhjet, rekomandimet në bazë të kërkesave të ligjit duke miratuar dhe kushtet dhe detyrat e monitorimit të zbatimit të projektit në baza të indikatorëve të përcaktuar.

Struktura e Raportit të VNM bazuar në ligjet dhe direktivat e sipërpërmendura përbëhet nga dhjetë seksionet e mëposhtme:

Seksioni 1: Hyrje

Seksioni 2: Baza ligjore, Metodologjia dhe Autoritetet Përgjegjëse

Seksioni 3: Përshkrimi i zonës së Projektit

Seksioni 4: Përshkrim i shkurtër i projektit dhe ndërhyrjet kryesore

Seksioni 5: Ndikimet në mjedis

Seksioni 6: Monitorimi

Seksioni 7: Rekomandime të përgjithshme

Seksioni 8: Bibliografia

Ky studim “Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne Gjirokaster”, merr parasysh dhe bazohet në të gjitha kërkesat e legjislacionit përkatës shqiptar, VKM-të dhe Direktivat e BE-së.

2. BAZA LIGJORE, METODOLOGJIA DHE AUTORITETET PERGJEGJESE

2.1. BAZA LIGJORE

Politikat mjedisore të shtetit shqiptar në periudhën postkomuniste lidhur me ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit kanë shënuar një përmirësim të kuadrit ligjor, duke e përafruar atë me atë të vendeve të BE-së. Zbatueshmëria e këtij kuadri ligjor ka lënë shumë për të dëshiruar pasi ka patur një degradim të mjedisit si pasojë e zhvillimeve kaotike të cilat kanë zvogëluar sipërfaqet e gjelbërta, kanë sjellë rritje të ndotjes së ajrit, të ndotjes akustike etj duke e bërë një domosdoshmëri forcimin e zbatueshmërisë ligjore. Rritja e shkallës së ndërgjegjshmërisë për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm duke patur në fokus edhe mjedisin, ka sjellë një ndryshim të sjelljes së institucioneve shtetërore dhe shoqërisë. Sidoqoftë mbetet shumë për të bërë për një edukim mjedisor, për zbatimin e detyrave të përcaktuar nga dokumente, raporte etj. të lidhura me mjedisin. Realizimi i koncepteve të “zhvillimit të qëndrueshëm”, mjedisi socio-mjedisoro-ekonomik i qëndrueshëm paraqitet gjithnjë e më i vështirë për të përcaktuar një kufi të qartë. Sidoqoftë thelbi është që shfrytëzimi i burimeve të mjedisit të bëhet bazuar në parime që i japin mundësi brezave që pasojnë ta përdorin atë me po të njëjtat mundësi që kemi edhe ne sot.

Qeveria shqiptare harton në mënyrë periodike vjetore një raport mbi gjendjen e mjedisit mbi bazën e të cilëve janë hartuar disa strategji për mjedisin, strategji ndërsektoriale, etj'. Gjithashtu projektet madhore, planet vendore etj shoqërohen me dokumenta si Vlerësime Strategjike Mjedisore, Vlerësime të Ndikimit në Mjedis (paraprak apo të thelluar) etj të cilat bëjnë të mundur evidentimin paraprak të problemeve mjedisore të lidhura me zonat në studim, japin alternativat më të mira me ndikim minimal negativ mbi mjedis si dhe përcaktojnë indikatorët për ndjekjen e zbatimit të këtyre projekteve. Në këto dokumente merret parasysh edhe mendimi i shoqërisë civile, banorëve të zonës dhe i grupeve të interesit përmes dëgjësave publike dhe mundësive të tjera të komunikimit.

Ndër dokumentet dhe ligjet që janë shfrytëzuar për realizimin e këtij raporti mund të përmendim:

- Ligji nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- Ligji nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”;
- Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji nr.8897, date 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", amenduar me ligjin Nr.10 266, datë 15.4.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8897, datë 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja";
- Ligji nr. 9385, date 4.05.2005 “ Për pyjet dhe shërbimin pyjor” amenduar nga ligjet: Ligji nr. 9533, date 15.05.2006 “ Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 9385, date 4.05.2005 “ Per pyjet dhe shërbimin pyjor”;
- Ligj nr.9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar; Ligj nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;
- Ligj nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”;
- Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit “;
- Ligji Nr. 8906 i datës 06.06.2002, “Për Zonat e Mbrojtura” (i amenduar me Ligjin nr. 9868, datë 4.02.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”);

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne
Gjirokastr

- Ligj nr.9010 datë 13.02.2003 “Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”;
- Ligji Nr. 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;
- Ligji nr.9108, datë 17.07.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”;
- Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”;
- Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”.

Ndër VKM më të rëndësishme mund të përmendim:

- o VKM Nr.912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- o VKM Nr.13, datë 4.1.2013 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- o VKM nr.994 datë 02.07.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”;
- o VKM nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”;
- o VKM nr.435, datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”;
- o VKM Nr. 103, datë 31.03.2002 “Për Monitorimin Mjedisor në Republikën e Shqipërisë”;

si dhe dhe udhëzimet:

- Udhëzim nr.6527 datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre”;
- Udhëzim nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.

Zbatimi i ligjeve në fuqi dhe i udhëzimeve të dokumenteve do të sillte një përmirësim të ndjeshëm në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit në vend. Në kuadrin e këtyre ligjeve dhe dokumenteve është hartuar edhe kjo VNM paraprake.

2.2. METODOLOGJIA

VKM-ja nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis” përcakton qartë modelin e metodologjisë që duhet ndjekur në hartimin e VNM-së. Qëllimi i metodologjisë është të sigurojë një mjet menaxhimi për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis në Shqipëri dhe të lehtësojë realizimin e një procesi eficient të VNM-së për çdo projekt të paraqitur për miratim. Qëllimi final është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projekt-propozimet, para dhënies së lejes së zhvillimit, të garantojë një proces të hapur vendimmarrjeje, përkrahimin e vlerësimit të ndikimeve negative mjedisore në kohën e duhur dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis, i përgjigjet në thelb, këtyre pyetjeve kyç:

- Si do të ishte mjedisi pa projektin (p.sh., studimet bazë)?

Kjo do të identifikojë dhe përshkruajë gjendjen aktuale të burimeve e karakteristikave

ekzistuese të mjedisit që mund të ndikohet nga projekti dhe se si do të zhvillohen ato në mungesë të tij.

- Çfarë do të ndodhë në mjedis si pasojë e zbatimit të projektit (p.sh., parashikimi)?

Kjo do të përshkruajë mjedisin siç është, pa projektin, dhe se si do të ndryshojë ai si pasojë e projektit, në aspektin e burimeve mjedisore apo njerëzore (receptorët), në natyrë dhe shkallën e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.

- A përbën kjo një shqetësim (p.sh., vlerësimi)?

Parashikimi i ndikimit nuk është i mjaftueshëm. Shumica e vendimmarrësve (dhe, sigurisht, shumica e stafit të autoritetit kompetent dhe e palëve të jashtme të interesuara) nuk kanë ekspertizën për të kuptuar se çfarë duan të thonë në të vërtetë gjetjet teknike të parashikimeve të ndikimit. Ata, gjithashtu, kanë nevojë për informacionin që i lejon të gjykojnë se sa i rëndësishëm (domethënës) është ndikimi, në mënyrë që të mund ta llogaritin atë, përkundrejt kostove dhe përfitimeve të tjera të projektit, në marrjen e një vendimi, nëse ai duhet të lejohet të zhvillohet.

- Nëse është i rëndësishëm, a mund të bëjmë ndonjë gjë në lidhje me të (p.sh., zbutja)?

Së fundi, është e rëndësishme të kuptohet se, në qoftë se ndikimi është i rëndësishëm, mund të bëhet diçka për të shmangur, për të reduktuar, për të korrigjuar apo për të kompensuar atë. Zhvilluesi i projektit mund t'i përfshijë këto masa zbutëse në propozimet e projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i përfshijë kërkesat përkatëse në kushtet e lejes së dhënë.

Në mënyrë që autoritetet kompetente dhe palët e jashtme të interesuara të vendosin nëse projekti duhet të vazhdojë, është thelbësore që informacioni mjedisor, i dhënë nga zhvilluesi në raportin e VNM-së, t'u përgjigjet në mënyrë të qartë pyetjeve të mësipërme. Qëllimi i studimeve të VNM-së është që të gjenerojë dhe të paraqesë këtë informacion në mënyrë të qartë, koherente dhe të saktë.

Objektivi kryesor i VNM-së është të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore të projekteve të reja të zhvillimit apo ndryshimeve të aktiviteteve ekzistuese. Brenda këtij qëllimi, procesi i VNM-së kërkon:

- të konsiderohen alternativat për vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqëruese;
- të përmirësohet plani mjedisor i propozimit;
- të sigurohet që burimet janë përdorur si duhet dhe në mënyrë eficiente;
- të identifikohen masat e duhura për zbutjen e ndikimeve të mundshme të propozimit;
- të vendosen kushtet për ndërtimin;
- të ndihmohet vendimmarrja dhe informimi i publikut.

2.3. AUTORITETET PERGJEGJESE

Në bazë të ligjit Ligji nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, në nenet 10 dhe 11 të tij përcaktohen qartë autoritetet shtetërore përgjegjëse për procesin e VNM-së:

Neni 10: Paraqitja e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi (Ndryshuar paragrafi i parë, me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015) përcakton se:

Zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë ministrisë, e cila ia përcjell AKM-së, dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë:

a) Për projektet e shtojcës II:

i) raportin paraprak të VNM-së, të hartuar sipas llojit të projektit; ii) projektin teknik të veprimtarisë; iii) faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji.

b) Për projektet e shtojcës I: i) raportin e thelluar të VNM-së, të hartuar sipas llojit të projektit; ii) përmbledhjen joteknike të raportit të VNM-së; iii) projektin teknik të veprimtarisë; iv) informacion për informimin dhe konsultimin me publikun; v) faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 11: Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për VNM-në paraprake (Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015) përcakton se :

1. Në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, AKM-ja merr vendim nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

2. Nëse AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, atëherë në vendimin e saj përcakton:

a) arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur mendimi; b) mendimin e institucioneve të konsultuara; c) përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar dhe, nëse është e mundur, për të korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis.

3. Vendimi i AKM-së për VNM-në paraprake i dërgohet ministrisë, i njoftohet palëve të përfshira në proces dhe publikohet në faqen elektronike të AKM-së dhe ministrisë. Ministria i dërgon zhvilluesit vendimin.

3. PERSHKRIMI I ZONES SE PROJEKTIT

3.1. GJENDJA EKZISTUESE E ZONES SE PROJEKTIT

Bashkia Gjirokastrë, si porta jugore e Shqipërisë, do të shërbejë si pol turistik për të gjithë rajonin, e nxitur nga traditat e pasura dhe trashëgimisë së shumëllojshme kulturore, në bashkëpunim me bashkitë e tjera fqinje duke formuar një aks të gjerë bipolar turistik e kulturor: Gjirokastrë – Berat dhe Gjirokastrë – Sarandë. Gjirokastra do të transformohet në qytetin e evenimenteve, e cila mund të marketohet me sloganin “Lugina e Mbretërve”.

Duke marrë parasysh faktin se Bashkia ka një pozicion gjeografik kyç, përbën një kanal komunikimi midis zonës bregdetare dhe qyteteve në brendësi të vendit, ndërsa ndodhet afër kufirit jugor kombëtar pasi autostrada SH4 është pjesë e Rrjetit Kryesor të Europës Juglindore dhe të zgjerimit të rrjetit qendror të transportit ndër-evropian në Europën Juglindore. Gjithashtu, vlen të përmendet edhe afërsia me Greqinë, me rrjetin rrugor cilësor të rrugës Egnatia, por edhe me portin e Igumenicës dhe aeroportin rajonal të Janinës.

Në bazë të të dhënave të analizës, Bashkia Gjirokastrë është një bashki me mjedis të pasur kulturor dhe trashëgimi interesante kulturore. Pra, në këtë bashki gjenden një numër i madh vendesh me interes historik dhe kulturor, si në qytetin e Gjirokastrës edhe në vendbanimet e tjera, kryesisht në ato që ndodhen në shpatin e malit Lunxhëri. Gjithashtu, një pikë e fortë e bashkisë është karakterizimi i bërë nga UNESCO, si një monument kulture i trashëgimisë botërore. Për të gjitha arsyet e përmenduar më sipër, Gjirokastra përbën tashmë një destinacion kombëtar dhe ndërkombëtar turistik.

Nën sipërmarrjen e Programit, AADF po kërkon ta kthejë rajonin e Gjirokastrës në një destinacion turistik me diversitet modelesh të aktiviteteve turistike, të gjitha të orientuara drejt qëndrueshmërisë. Qëllimi është të rritet ndërgjegjësimi global turistik, impakti dhe influenca e flukseve turistike për të vizituar zonën dhe bazat e tjera lokale turistike.

Politikat e fundit turistike dhe rritja e normave të turizmit në zonë i kanë dhënë një nxitje trafikut në zonë, veçanërisht në sezonin e lartë të turizmit, duke ushtruar presion në rrjetin rrugor dhe duke rritur kërkesën për parkim. Në mënyrë që të plotësohet kërkesa në rritje e parkimit është e nevojshme të sigurohen ambiente parkimi jashtë rrugës, në afërsi të zonave më të vizituara, ku parkuesit mund të arrijnë në destinacionin e dëshiruar sa më shpejt të jetë e mundur. Për të arritur akomodimin e të gjitha automjeteve dhe mjeteve të transportit të turizmit, AADF ka mbështetur përgatitjen e një projekti të detajuar për rivitalizimin e sheshit dhe parkimin nëntokësor në Sheshin Çerçiz Topulli, në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës, ndërsa punimet e zbatimit do të kryhen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Zona e zbatimit të projektit shtrihet në 3 parcela kadastrale me Nr. pasurie 8/142 me sipërfaqe 6112.8 m², 8/137 me sipërfaqe 3100 m² dhe 8/134 me sipërfaqe 521.5 m², të cilat sipas informacionit zyrtar të dhënë nga Bashkia Gjirokastrë janë të treja të regjistruar në regjistrat e hipotekës me status juridik të pronësisë SHTET. Kjo zonë është e mirënjohur në Gjirokastrë dhe nga turistë të shumtë pasi është sheshi që bën të mundur hyrjen në zonën e Pazarit të Vjetër të Gjirokastrës.

Metodika e ndjekur për analizën e zonës në studim u bazua në vërtetimet e grupit të punës në zonë, informacione nga burime të dyta si dhe nga studime të ndryshme të realizuara për zonën dhe më gjerë. Ndërhyrjet e deritanishme të njeriut kanë qenë pothuajse fare në këtë zonë, që pas ndërtimit të sheshit në vitet '60, kjo pasi ka mbetur e konservuar edhe pas viteve '90 dhe më vonë me mbrojtjen edhe nga UNESCO.

3.2. HABITATI DHE BIODIVERSITETI I ZONES NE STUDIM

Zona e Bashkisë Vlorë ka një mjedis tokësor të pasur në florë dhe faunë, si dhe ka një shumëllojshmëri të madhe të habitateve, e shoqëruar me një bimësi të një rëndësie të veçantë kombëtare. Flora e Bashkisë karakterizohet e pasur dhe e shumëllojshme dhe ndahet në katër zona fitoklimatike. Në zonat me lartësi më të ulët lokalizohen zonat gëmushore të cilat mbulojnë kryesisht hapësirat fushore dhe brezat të cilat mbulohen nga lisa. Këto ekzistojnë kryesisht në zonat gjysmëmalore dhe malore dhe përbëjnë brezin më të rëndësishëm fitoklimatik të zonës. Gjithashtu, brezi i tretë fitoklimatik është ai i bredhishtes mesdhetare dhe mbulohet nga pemë halore si pisha, rrape dhe bredha dhe lokalizohet në lartësinë 1000 – 1800m. Brezi i katërt është ai alpik i cili zhvillohet në lartësinë 1700 – 2400m dhe bimësia e tij karakterizohet kryesisht nga kullota të pasura. Por e rëndësishme është edhe tërësia e luleve dhe e bimëve faramceutike dhe terapeutike që lokalizohen në zonë dhe kryesisht në vëllimin malor Mali i Gjerë, shumë prej të cilave janë shumë të njohura nga popullsia lokale dhe kanë traditë shumëvjeçare në mbledhjen e tyre, qoftë për përdorim personal dhe familjar apo për shitje.

Për më tepër, në gjatësinë e lumit Drino dhe të përrenjve zhvillohet një bimësi ujore e cila përbëhet kryesisht nga shelgje, thana dhe murriza, ndërsa në shtratin e lumit Drino lokalizohen kultivime shumëvjeçare si fruta dhe kultivime një vjeçare si grurë.

Fauna e zonës është e shumëllojshme. Për shkak të ekzistencës së vëllimeve malore dhe të hapësirave pyjore, lokalizohen gjitarë të mëdhenj si arusha kafe, drerë, mace të egra, një sërë shpendësh dhe zvarranikësh. Në zonat gjysmëmalore dhe fushore, përveç deleve dhe dhive, lokalizohen dhe gjitarë të vegjël si lepuj dhe ketra. Së fundmi, bimësia pranë lumenjve, në kombinim me hapësirat e kultivuara dhe kullotat, ofrojnë kushte mbijetese për shumë insekte, mjaft zogj dhe peshq si ngjala dhe trofa.

3.3. PEISAZHI I SHESHIT

Peisazhi i ofruar nga vetë sheshi për zonën është vërtet i mrekullueshëm, gati si një kartvizitë, duke ofruar pamjen nga hyrja e qendrës historike dhe një panoramë të magjishme që të ofronky shesh përkundrejt lagjes Hazmurat dhe më gjerë me ndërthurjen me peisazhin e luginës së lumit Drino dhe vargmalit Shëndëlli-Lunxhëri-Bureto.



Figura 1- Vizualizim nga sheshi pas implementimit të projektit (burimi: Projektuesi)

Ky element në vëzhgimin e projektuesit vlen të evidentohet më qartë. Në kushtet e gjendjes ekzistuese përtej makinës, që aktualisht është protagoniste fizike – vizuale e sheshit dhe atmosferës së tij, ka edhe shumë elementë të tjerë fizikë formulues, që e përkeqësojnë pasurinë potenciale vizuale të tij në marrëdhënie me panoramën në Veri. Elementi funksional i parapetit të murit mbajtës të sheshit në kufirin Verior të tij si edhe pemët dekorative të mbjella së fundmi përgjatë gjithë perimetrit të tij, përkeqësojnë, apo thënë edhe më troç, ndërpresin vijueshmërinë e panoramës së mrekullueshme prezantuese, që vizitori mund të marrë nga ky shesh. Në reflektim e sipër, projektuesi në të kundërt ka menduar se si mund ta përmirësojë këtë detaj potencial për impaktin dhe atmosferën, që një vizitor i merr menjëherë Gjirokastrës dhe kjo të vijë si pjesë integrale e një ndërhyrje më të gjerë funksionale-estetike-urbane.



Figura 2- Vizualizim nga hotel Çajupi pas implementimit të projektit (burimi: Projektuesi)

4. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

4.1. OBJEKTIVAT

Objektivi kryesor i projektit është rivitalizimi i sheshit të Çerçizit dhe ndërtimi i parkimit nëntokësor në sheshin Çerciz Topulli, për të akomoduar dhe ndihmuar menaxhimin e rritjes së flukseve turistike, njëkohësisht duke sjellë koherencë në hapësirat urbane pa ndryshuar trashëgiminë kulturore të Gjirokastrës.

Objektivat e përgjithshëm të këtij projekti janë:

1. Rivitalizimi i sheshit Çerciz Topulli
2. Rivitalizimi i sheshit të Bashkisë Gjirokastrë
3. Rikonstrukcioni dhe rehabilitimi i fasadës së Hotel Çajupit
4. *Konstruksioni i parkimit nëntokësor në sheshin Çerçiz Topulli, në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës.*

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne
Gjirokastr




Figura 3- Kufinj të zonës së propozuar të projektit (burimi: Projektuesi)



Figura 4- Foto panoramë nga sheshi ekzistues i Çerçiz Topullit (burimi: Eksperti)



Figura 5- Foto nga sheshi ekzistues me fokus bustin e Çerçiz Topullit (burimi: Eksperti)



Figura 6- Foto nga pjesa hyrëse e sheshit Çerçiz Topullit (burimi: Eksperti)


4.2. ANALIZA E DIZAJNIT

Përlllogaritja e numrit të nevojshëm të parkimeve nis nga studimi flukseve aktuale të parkimit publik dhe më tej pritshmërive për numrin e vizitorëve në perspektivë. Aktualisht në një vëzhgim të bërë nga projektuesi, parkimi publik ekzistues prej 80 autoveturash është pothuajse gjatë gjithë ditës i plotësuar dhe në orë të caktuara edhe i pamjaftueshëm, duke detyruar vizitorët të gjejnë alternativa të tjera të mundimshme në brendësi të qendrës historike. Pra, në kushtet aktuale numri i parkimeve të nevojshme duhet të jetë të paktën 120 makina ku në fundjavë edhe më tepër se 150 makina. Ndërkohë rigjenerimi tërësor me

investime publike restauruese i kalasë, pazarit, shtëpive të kategorisë së parë, etj, do të rrisin gjithnjë e më shumë interesin e vizitorëve vendas dhe të huaj në të ardhmen. Aktualisht kapacitetet hoteliere të qendrës historike të Gjirokastrës janë të pamjaftueshme për të përballuar flukse vizitorësh në të ardhmen. Gjithsesi, po vihen re tendenca të adaptimit të godinave ekzistuese në funksione hoteliere siç është rasti i shtëpisë Babameto. Me kryerjen e investimeve publike të sipërpermendura do të rritet në vazhdim interesi për shtesa në numrin e shtreterve hotelier në qendrën historike. Ky do të jetë një proces i vazhdueshëm paralel, por që do reflektojë në të ardhmen edhe kërkesa për parkim në momentin e arritjes.

Gjithashtu, përveç vizitorëve vendas dhe të huaj, që kryesisht jetojnë e punojnë në Shqipëri, në të ardhmen mund të ketë flukse vizituesh nga vendi fqinj, Greqia. Përveç organizimeve me agjensi udhëtimesh me autobuza do mund të ketë edhe flukse të tjera spontane nga shtetas Grek apo të huaj, që do mund të vizitojnë Gjirokastrën me makina personale apo të marra me qera. Edhe këta do duhet të përllogariten në numrin e përgjithshëm të vizitorëve të cilët do duhet të shërbehen me parkim gjatë harkut të ditës.

Godina e Bashkisë si Institucioni më i rëndësishëm publik lokal duhet të ketë të paktën 20-30 vende parkimi të dedikuara. Shumica e punonjësve të tij jetojnë në lagjen e re të Gjirokastrës “18 Shtatori” e cila është fizikisht e pamundur të arrihet përveçse me transport publik ose mjet transporti privat. Kështu të paktën 20% e stafit duhet përllogaritur në numrin e parkimeve të nevojshme të dedikuara për institucionin e Bashkisë.



Gjithashtu, edhe një numër makinash, të paktën 4-5 duhet përllogaritur për vizitorët bashkëpunëtorë ditor të saj. Parkim i dedikuar duhet përllogaritur edhe për hotel turizmin “A.Z. Çajupi”, i cili ka një kapacitet prej 40 dhomash ku të paktën për gjysmën e tyre duhet përcaktuar parkim i dedikuar, duke përllogaritur mesatarisht 70% të përmbushjes së kapacitetit të tij dhe faktin, që 1 makinë mund t’i përgjigjet 2 dhomave njëkohësisht. Pra, në total rreth 20 makina të dedikuara për hotel “A.Z. Çajupi”-n.

Vetëm në kushtet aktuale do kishte nevojë për më shumë se 200 makina me përllogaritjet e përafërta për të gjitha funksionet e mësipërme. Por nevojat për parkim duhen parë në kontekstin e zhvillimeve në perspektivë. Që prej 2 vitesh Gjirokastra është jo më shumë se 3 orë larg nga Tirana dhe me përfudimin e unazës së Fierit planifikohet të jetë jo më shumë se 2.5 orë, që do të thotë se është më se i arritshëm nga kryeqyteti i Shqipërisë.

Fenomen i ngjashëm me një tjetër qytet të ngjashëm për nga vlerat historike kulturore dhe arkitekturore është rasti i Korçës ku afrimi i distancës me Tiranën jo më shumë se 3 orë (pritet të shkurtohet akoma deri në 2.2 orë) larg dhe investime të rëndësishme publike kanë sjellë transformimin e saj në destinacion fundjavë. Në kontekstin e investimeve publike Gjirokastra është akoma shumë prapa asaj, që është bërë me Korçën, por fokusi i Qeverisë është përqëndruar tashmë ndaj këtij thesari kombëtar dhe investimet në bypass-in e qendrës historike, që do të largojë trafikun nga pazari, restaurimi total i pazarit historik si edhe rijetesimi i sheshit “Çerçiz Topulli” do të jenë boshti kryesor i asaj, që do të bëjë të

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne
Gjirokastrë

mundur rikthimin e sharmit të Gjirokastrës, duke e shndërruar atë në destinacion turistik për vizitorët vendas dhe të huaj. Sa më sipër thënë, do të nxitet rritja e kapacitetit dhe cilësisë së dhomave hoteliere dhe shërbimeve në tërësi, që aktualisht lënë për të dëshiruar. Gjithashtu, restaurimi i pazarit do të përmiresojë ndjeshëm edhe ndriçimin e tij dhe për rrjedhojë do të zgjasë orët e shërbimit gjatë darkës, që sot janë të vdekura pas orës 6 në sezonin e dimrit.

Të gjitha sa më sipër e çojnë projektuesin në vizionin e të ardhmes, që ta planifikojë atë sa më afër realitetit të zhvillimeve perspektive lidhur me numrin potencial të vizitoreve dhe shërbimit të tyre me të gjitha elementet e domosdoshëm të aksesit dhe mirëpritjes urbane. Në këtë kontekst projektuesi ka analizuar potencialin, që përmban sheshi “Çerçiz Topulli” për realizimin e një parkimi nëntokësor pa cënuar morfologjinë ekzistuese të sheshit si pjesë e memories historike të qendrës historike.




Figura 7- Seksion tërthor dhe gjatësor i sheshit ekzistues të Çerçiz Topullit (burimi: Eksperti)

Sheshi “Çerçiz Topulli” i ndërtuar rreth viteve ’60 është realizuar me mbushje në relievin ekzistues të kodrës së kalasë dhe mbajtja e tij me një mur perimetral masiv prej guri nga 6-8 m i lartë. Kufijtë e tij janë përcaktuar dhe përkufizuar me objektin e hotel Turizmit “A.Z.Çajupi” dhe murin në “këmbët” e godinës së Bashkisë në Jug. Dimensionin total të sheshit në kushtet aktuale është 37x110m. Projekti ka marrë parasysh këtë dimension gjeometrie për të parë mundësinë se çfarë numri makinash mund të sigurohen potencialisht si maksimum nga një parkim nëntokësor pa ndryshuar morfologjinë ekzistuese të sheshit. Me 1 kat parkim realizohen 98 makina me 2 kat 198 makina dhe me 3 kat 298 makina. Pra, kjo

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne
Gjirokastrë

është baza ku vendimarrja duhet të bazohen lidhur me numrin e makinave të realizuara dhe investimin, që do duhet të kryhet për ta mundësuar. Duhet theksuar edhe një herë, që realizimi i këtij parkimi ka marre parasysh, që pas realizimit të tij, kufijtë gjeometrike të sheshit të jenë absolutisht ato të sotmet, pikërisht për të ruajtur memorien historike, që nga krijimi i sheshit në vitet '60 memorie, që ka rritur të paktën një brez dhe ndërkohe breza e breza të tërë në vazhdim. Madje projektuesi është kujdesur, që në rast se nga Keshilli i Restaurimit të vlerësohet tepër e rëndësishëm edhe vetë muri si element përbërës i trashëgimisë, projekti pavarësisht ndërtimit të parkimit nëntokësor në 2 apo 3 kate ta risjellë identik po ashtu siç është sot.

Njëkohësisht projekti ka propozuar përmirësimin e arkitekturës së tij, duke e futur atë në karakteristikat e arkitekturës Gjirokastrite, me elementët e arkadës me harqe dhe ritëm. Kjo arkitekturë është aplikuar edhe më parë si në rastin e murit nën "këmbët" e Bashkisë ku projektuesit kanë simuluar një arkadë me 7 harqe guri të vendosura në ritëm. Kjo arkitekturë është aplikuar pikërisht në vitet '60 kur është ndërtuar edhe sheshi "Çerçiz Topulli" dhe muri mbajtës perimetral i sheshit në Veri të tij. Duket që projektuesit janë kujdesur, që ta vlerësojnë me arkitekturë të spikatur murin tepër të dukshëm nga sheshi "Çerçiz Topulli" dhe në të kundërt nuk janë kujdesur po me të njëjtën vëmendje për murin mbajtës perimetral të sheshit. Kjo me sa duket për faktin, që muri mbajtës është i padukshëm nga vetë sheshi dhe si i tillë jo aq i rëndësishëm për t'u vlerësuar nga pikëpamja arkitektonike.



„We propose a return to the wall with characteristic arches and gray color, to experience Gjirokastra with the traditional elements. In this way we promote the forgotten spaces of the square in front of the square pioneers and unified the proposed wall with existing arches by recalling the traditional element of arcs.



Figura 8- Propozimi i ruajtjes së harqeve karakteristike me ngjyrë gri dhe elementëve tradicionalë të Gjirokastrës dhe shfaqja e tyre te muri i ri kufizues i parkimit. (burimi: Eksperti)

Por në fakt në këtë kontekst me sa duket është harruar, që ky mur ka peshë të mirëfilltë vizuale nga sheshi panoramik (sot hotel Kodra), që përbën një pikë të mrekullueshme turistike nga ku kundrohet dhe fotografohet kalaja me të gjithë magjinë e saj. Pavarësisht se në shkallën vizuale të kësaj panorame, pikërisht muri perimetral i sheshit luan një rol relativ ai është përsëri i rëndësishëm pasi së bashku me harqet e murit mbi

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne
Gjirokastr

shesh mund të përbëjë një siluet të rëndësishëm, që e fut gjithë situatën e sheshit në një ansambël pamor. Projekti e ka sjellë arkitekturën e murit më arkada guri masiv me harqe me rreze 4m të vendosura në ritëm një herë me 3 harqe dhe më pas me 6 harqe. I gjithë ky interpretim për të shmangur monotoninë vizuale. Për të pasuruar edhe dinamikën vizuale i gjithë silueti “thyhet” me shkallën funksionale në Perëndim, që realizon lidhjen e sheshit “Çerçiz Topulli” me pjesën e sheshit poshtë në Veri perpara qendrës kulturore të fëmijëve (“ish Shtëpia e Pionierit”). Arkitektura e kësaj shkalje është një sjellje e përafërt e arkitekturës së shkallës tek kulla e sahatit të kalasë dhe shumë të tjerave të ngjashme të përdorura në shkallët e jashtme të shtëpive karakteristike Gjirokastrite.




Figura 9- Diagrama e lëvizshmërisë së sheshit Çerçi Topulli. Propozimi i hyrjes së Parkimit Nëntokësor.
(burimi: Eksperti)

Hyrja në parkim është realizuar në ekstremin Lindor të murit perimetral të sheshit “Çerçiz Topulli” e lidhur drejtpërdrejt me rrugën hyrëse automobilistike në rrethrrrotullimin e manovrës së kthimit të makinave. Kjo hyrje është pothuaj e padukshme pasi morfologjia në këtë pjesë është e tillë, që është pothuaj e padukshme. Ulja me rampë e kuotës ndihmon vizualisht edhe këtë kalim këmbësor, që në kushtet e sotshme ngjan me një “sandëich” psikologjik ku lartësia e vetë murit perimetral dhe e shtëpisë ekzistuese në krah krijon presion vizual dhe shtuar këtu edhe vështirësinë e ndryshimit të kuotës me shkallare, tepër e vështirë dhe aspak ftuese për ta përshkuar. Projekti është përpjekur ta përmirësojë këtë moment urban pikërisht, duke ndërthurur gjeometrinë, që jep rampa e hyrjes në parkim me ulje të këndshme si edhe transformimit të shkallares në rampë këmbësorësh.

4.3. KONCEPTI I PARKIMIT NENTOKESOR

Parkimi është konceptuar në 3 kate. Rampa e lidhjes vertikale të saj është pozicionuar direkt që në hyrje në mënyrë që manovrat e tjera në shpërndarjen në kat të kryhen në normalitet. Ne hyrje është pozicionuar edhe një kontroll aksesit i cili do të shërbejë për kontrollin e hyrjes dhe daljes së automjeteve. Dalja në shesh e këmbësorëve bëhet me një trup vertikal shkallë+ashensor të pozicionuar në orientimin Perëndimor të tij pikërisht atje ku fluksi i lëvizjes së makinave është më i ulët. Ngjitur me këtë trup në katin -1 është menduar një bllok tualetesh publike (meshkuj, femra dhe persona me aftësi të kufizuar).




Figura 10- Pozicioni i vendosjes së parkimit nëntokësor të propozuar. (burimi: Eksperti)

Bloku volumor nëntokësor i parkimit ndjek morfologjinë e pjerrësisë së sheshit. Gjeometria e kësaj pjerrësie ndiqet në çdo kat të parkimit. Soleta e sipërme është 5.5%, ndërkohë që pjerrësia e soletave nëntokë është 3.5%. Bloku volumor distancohet nga volumi ekzistues i hotel A.Z.Çajupit me distancë sigurie konstruktive 5 m larg tij.




Figura 11- Seksion tërthor i parkimit nëntokësor të propozuar. Ruajtja e distancës së sigurisë prej 5 metra nga hoteli ekzistues (burimi: Eksperti)




Figura 12- Seksion gjatësor i parkimit nëntokësor të propozuar. Ruajtja e pjerrësisë ekzistuese të sheshit.
(burimi: Eksperti)




Figura 13- Planimetri e parkimit nëntokësor. (burimi: Eksperti)

Një ndër tiparet më me vlere të projektit është ventilimi natyral. Për ventilimin e projektit "Rivitalizimit të sheshit "Çerciz Topulli" dhe parkimit nëntokësor, në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës", i kemi referuar Standartin BS 7346-7:2013 "Components for smoke and heat control systems – Part 7".

Meqë sipërfaqja e një kati parkimi është afërsisht 2400 m², për të realizuar një ventilim natyral duhet që të kemi sipërfaqe të hapur sa 5% e sipërfaqes së një kati parkimi (sipas BS 7346-7:2013, paragrafi 6.2). Në këtë rast sipërfaqet e arkadave duhet të jenë në total 120 m² për çdo kat. Në këtë rast sipërfaqja e arkadës nuk mund të arrihet , dhe ventilimi është kombinuar me atë mekanik.

Përgjatë soletave të parkimeve të cilat janë në dukje nga arkadat janë pozicionuar vazeta lulesh për të ulur impaktin vizual të makinave të parkuara. Gjithashtu, janë vendosur ndriçues përgjatë arkadës për të theksuar ritmin e çarjeve. Ndriçimi është zgjedhur me tone të ndryshme nga ndriçimi i arkadës, për të mos konkuruar me njëra-tjetrën.

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetese ne
Gjirokaster



Figura 14- Pamje e parkimit nëntokësor dhe arkadave nga sheshi përballë Shpisë së Pioneerëve. (burimi: Eksperti)

Në soletën e katit -2, në hapësirën poshtë shkallareve që lidhin sheshin Çerçiz me sheshin pranë shtëpisë së Pioneerëve, është pozicionuar kabina elektrike, e cila ka ventilim të jashtëm falë nivelit të gjelbërimit, dhe mund të aksesohet nga kati -2.




Figura 15- Pamje e shkallareve që lidhin sheshin Çerçiz me sheshin pranë shtëpisë së Pioneerëve dhe kabinës elektrike poshtë tyre. Detaj gjelbërimit dhe ndriçimi i propozuar. (burimi: Eksperti)

5. NDIKIMET NE MJEDIS

5.2. MJEDISI SOCIAL-EKONOMIK

5.2.1. Demografia

Nga pikëpamja demografike, sipas ndarjes së re territoriale me reformën e re të bazuar në ligjin Nr. 115/2014, "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësitë të Qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia e Gjirokastrës i përket Prefekturës Gjirokastrë, ë gjendet në Jug të Shqipërisë dhe përfshin Njësitë Administrative Gjirokastrë, Antigone, Çepo, Lazarat, Lunxhëri, Odrie dhe Picar. Sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të vitit 2011 Bashkia Gjirokastrë kishte një popullsi prej 28'673 banorë dhe kjo shifër përbën 39.73% në lidhje me popullsinë e përgjithshme të Prefekturës Gjirokastrë ndërsa, në lidhje me popullsinë totale të Shqipërisë (2'800'138, sipas regjistrimit të vitit 2011) ka përqindjen prej 1.02%.

Gjirokastra është qendra e Bashkisë Gjirokastrë, ka një popullsi prej 19'836 banorë dhe posedon përqindjen prej 69.18% të popullsisë së Bashkisë dhe 27.48% të asaj të Prefekturës. Pas Gjirokastrës zona më e populluar e Bashkisë është fshati Lazarat me 2'801 banorë, ndërsa vendbanimi me popullsi më të vogël është fshati Odrie (me 433 banorë). Të njëjtën hierarki ndjekin edhe ndërtimet, kështu numrin më të madh të tyre e ndeshim në qytetin e Gjirokastrës dhe më e pakta në fshatin Odrie.

Nga ish Njësitë Administrative të Bashkisë Gjirokastrë, me përjashtim të qendrës me të njëjtin emërtim e cila përbën një qendër urbane të rëndësishme dhe zonën e fshatit Lazarat që përbën një zonë periferike, zonat e tjera janë zona bujqësore.

	Banesat					
	Popullsia banuese	Ndërtesat	Banesat gjithsej	Banesa të zakonshme të banuara	Banesa të zakonshme jo të banuara	Banesa jo të zakonshme
AUBANIA	2800138	598267	1012062	706046	302197	3819
GJIROKASTËR (Qarku)	72176	26037	37119	20991	15962	166
GJIROKASTËR (Bashkia)	28673	6919	11987	8085	3881	21
ANTIGONË	998	331	399	284	115	-
CEPO	1727	1049	1121	521	600	-
GJIROKASTËR	19836	3113	7792	5715	2067	10
LAZARAT	2801	816	848	604	241	3
LUNXHËRI	1941	815	992	558	430	4
ODRIE	433	285	296	151	145	-
PICAR	937	510	539	252	283	4

Tabela 1: Popullsia rezidente, ndërtimet për qëllime banimi dhe banesat sipas bashkisë/komunës dhe llojit të banesave (burimi: PPV Gjirokastrë)

Siç mund të shihet edhe nga tabela 1, në zonat bujqësore të Bashkisë ka një numër të madh banesash të pabanuara, ndërsa në zonat urbane Gjirokastrë dhe Lazarat përqindja e tyre është ndjeshëm më e vogël (26.53% dhe 28.42% respektivisht). Në rezultatet e

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne
Gjirokaster

mëposhtme paraqitet tendenca në rritje që vihet re në dhjetëvjeçarët 1989-2011 në Shqipëri, për braktisjen e zonave bujqësore dhe transferim në zonat urbane.

Modeli i ndryshimit të popullsisë në nivelin e qarkut përkon, në një masë të madhe, me modelin e migrimit të brendshëm që tregon se, përveç migrimit dhe shtimit natyror, migrimi i brendshëm është një proces kryesor për ndryshimet e popullsisë në Shqipëri. Për Bashkisë Gjirokastrë konkretisht, ndryshimi i popullsisë paraqet shenja negative edhe 7 ish Njësitë Administrative që e përbënin atë. Nga tabelat rezulton se ulje më të madhe në popullsi paraqesin zonat e vogla bujqësore Picar dhe Odrie me ulje 71.61% dhe 70.06% respektivisht, gjatë njëzet vjeçarit 1989-2011.

Ish Bashkia/ Komuna	Popullsia			Ndryshimi '89-'11	Ndryshimi '01-'11	Vendi i klasifikimit		
	1989	2001	2011	%	%	1989	2001	2011
ANTIGONE	1288	1224	998	-22.52%	-18.46	7	6	5
ÇEPO	4790	3024	1727	-63.95%	-42.89	2	3	4
GJIROKASTËR	24208	20601	19836	-18.06	-3.71	1	1	1
LAZARAT	2907	3155	2801	-3.65%	-11.22	5	2	2
LUNXHËRI	4133	2820	1941	-53.04%	-31.17	3	4	3
ODRIE	1446	561	433	-70.06%	-22.82	6	7	7
PICAR	3300	1656	937	-71.61%	-43.42	4	5	6

Tabela 2: Ndryshimi i popullsisë ndërmjet viteve 1989-2011 (burimi: PPV Gjirokastrë)

Shifrat e mësipërme të popullsisë të regjistruara nga Shërbimi i zyrave të gjendjes Civile të Bashkisë, na japin tablonë më të fundit të popullsisë së Bashkisë dhe pasqyrojnë edhe trende të reduktimit të popullsisë. Një vlerësim i popullatës së Bashkisë që është bërë për vitin 2016, bazuar në parashikimin përkatës të INSTAT për rajonin e Gjirokastrës, ku INSTAT procedoi tre raunde të parashikimeve të popullsisë. Raundi i parë u bazua në regjistrimin e vitit 1989 dhe ka bërë parashikimie për një horizont kohor prej 21 vitesh. Parashikimet e përditësuara të popullsisë të bazuara në regjistrimin e vitit 2001 u zgjatën deri në vitin 2021 (raundi i dytë). Raundi i tretë i parashikimeve vlerëson popullsinë deri në vitin 2031 në nivel kombëtar dhe rajonal, në bazë të regjistrimit të fundit, dhe ka si qëllim informimin për të gjitha trendet e mundshme demografike dhe sfidat në të ardhmen. Sipas raportit që paraqet rezultatet e raundit të tretë, popullsia e rajonit Gjirokastrë vlerësohet në 70'532 banorë për vitin 2016.

Njësia Administrative	Persona / km2
ANTIGONE	25.09
CEPO	14.74
GJIROKASTËR	667.07
LAZARAT	66.52
LUNXHËRI	26.54
ODRIE	12.1
PICAR	6.68

Tabela 3: Dendësia e popullsisë në nivel ish njësie administrative (burimi: PPV Gjirokastrë)

Duke reduktuar në këtë përmasë të popullsisë përqindjen prej 39.73%, e cila është raporti i popullsisë së Bashkisë në lidhje me popullsinë e qarkut për vitin 2011, rezulton një përmasë popullore për Bashkinë me vit referues 2016 të barabartë me 28'023 banorë. Duke krahasuar këtë vlerësim me popullsinë e regjistruar të Bashkisë për vitin 2011 (28'673 banorë) rezulton një vlerësim për një ulje të popullsisë të barabartë me 2.27% (2011-2016). Përsa i përket densitetit të popullsisë paraqitet mëposhtë:

5.2.2. Ndikimi gjatë fazës së zbatimit të projektit në komunitet

Gjatë fazës së zbatimit të projektit në zonën në studim mund të preken shërbimet komunale si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energjia elektrike për disa banorë përreth zonës, edhe rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza dhe ujrave të shiut mund të ketë ndërhyrje dhe ndryshime për shkak të ndërhyrjes së projektit. Gjithashtu, në vëmendje duhet patur industria e turizmit gjë e cila kërkon një vëmendje të veçantë nga ana e projektuesit dhe e zbatuesit në këtë projekt, duke qenë se gjatë zbatimit të punimeve, aksesimi për në pazarin e vjetër nga Sheshi i Çerçizit do të jetë i pamundur, gjithashtu mund të ketë edhe problematika në funksionimin e rregullt edhe të hotel Çajupit, madje ndoshta edhe të Bashkisë Gjirokastrë duke qenë se hyrjen e kanë nga sheshi.

Bazuar në këto ndikime duhet të merren masat e nevojshme për t'i shmangur maksimalisht ose minimalisht për t'i zbutur ato. Këto ndikime do të jenë edhe në varësi të stinës së punimeve e cila do të mëshohet që ndërtimi të paktën i strukturës së parkimit të kryhet të paktën jo gjatë muajve të cilët janë shumë të rëndësishëm për turizmin jetik të qytetit.

5.2.3. Masat korrigjuese/zbutëse

Gjatë fazës së zbatimit kontraktuesi duhet të zbatojë kushtet e kontratës ku duhet të jenë të përcaktuar me hollësi protokollin i veprimit për mosndërprerjen e shërbimeve komunale për të gjitha njësitet që mund të preken. Kanalet e kullimit dhe të ujitjes, si dhe të ujrave të zeza, por edhe furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike duhet të jenë pjesë e këtyre masave. Makineritë që do të përdoren duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi lidhur me nivelin e zhurmave që ato gjenerojnë duke i pajisur ato me aksesore "silenciatorë". Në rastet kur ndërprerja është e domosdoshme dhe e pashmangshme duhet të njoftohet komuniteti të paktën 24 orë përpara.

Koordinimi në kohë nga ana e zbatuesit të projektit me autoritetet përgjegjëse lokale dhe shtetërore si dhe me kompanitë përkatëse të sigurimit të shërbimeve (UKV, OSHE, bashkia Vlorë, etj) do të sillte uljen në minimum të ndikimeve negative. Hartimi i një plani paraprak veprimi përpara funksionit tërësor të projektit, i hartuar në bashkëpunim midis sipërmarrësit të punimeve dhe kontraktuesit punëdhënës do të përmirësonte cilësinë e shërbimeve.

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbështetëse ne
Gjirokastr

Tabela 4- Ndikimet në socio-ekonomi				
Faza	Burimi i ndikimit	Ndikimi	Shkalla e ndikimit	Masat zbutëse
Ndikimi gjatë fazës së ndërtimit në social-ekonominë	1.Rrjet furnizim uji 2. Energji elektrike 3. Sistem ujitje 4. Sistemi kullimit 5. Rritje ndotjes akustike.	1. Bllokim i kanalizimeve 2.Rritje nivelit të zhurmave si pasojë e punimeve dhe makinerive	E mesme	1.Kushtet e kontrates (me penalitete) të specifikojnë që kontraktuesi të marrë masa e domosdoshme dhe të nevojshme për shmangjen e ndikimeve sipas specifikimeve teknike. 2. Respektimi i ligjit 9774, udhëzimit nr.8/2007.
Ndikimi në social-ekonominë në përfundim të punimeve	1.Ulje e shpejtesisë mesatare të lëvizjes dhe rritje e volumit të trafikut për shkak të kalimit të automjeteve të transportit të dherave dhe autobetonierëve	1.Shtohet rreziku për aksidente rrugore; 2.Ulet siguria këmbësore. 3.Rritje e ndotjes akustike	E mesme	1.Vendosja e sinjalistikës rrugore (tabela dhe vijeziomet); 2.Pajisje me barriera mbrojtëse akustike në zonat e banuara.rrrrr

5.2.4. Ndikimi gjatë fazës së funksionimit në komunitet

Menjëherë pas përfundimit të ndërtimit të parkimit nëntokësor dhe të vendosjes së elementëve urban të projektuar të sheshit të Çerçizit, do të vërehet një numër i shtuar turistësh dhe rritje të njerëzve të punësuar, pasi tashmë hyrja për në pazarin e vjetër do të jetë e transformuar tërësisht. Funksionimi i projektit nuk ndikon në shërbimet komunale përveç gjenerimit të mbetjeve të cilat do të merren përsipër nga vetë sipërmarrësi për tu larguar në vendet përkatëse të depozitimit të mbetjeve.

Do të tregohet një kujdes i veçantë për sipërfaqet e gjelbra të sapokrijuara dhe pemët e mbjella rishtas. Do të ishte mjaft pozitive sikur këto hapësira të kishin sisteme automatike të ujitjes, ose të kishte kujdes të veçantë nga mirëmbajtësit pasi duke marrë në konsideratë temperaturat në periudhën e verës rrezikohen të thahen. Një element i rëndësishëm është verifikimi i zhurmave që mund të vijnë nga qarkullimi i automjeteve i cili do të rritet sidomos në sezonin e verës. Vendosja e sinjalistikës, barrierave mbrojtëse në të dy anët e rrugës do të ulnin ndikim negativ mbi shëndetin e popullatës në zonë.

5.3. TRASHEGIMIA KULTURORE

Qyteti i Gjirokastrës është i njohur jo vetëm për karakterin e tij arkitektonik, por për historinë e saj, traditat dhe kulturën e saj që transmetohet brez pas brezi, duke lënë një trashëgimi shumë të pasur shpirtërore. Sidoqoftë nuk është rastësor fakti që në vitin 1968 qyteti u emërua “Qytet Muze” nga qeveria, në mënyrë që të ruhet trashëgimia e saj arkitektonike dhe kulturore, ndërsa më 15 Korrik 2005, sipas mbledhjes së komisionit të UNESCO-s që u realizua në Durban të Afrikës së Jugut, komisioni votoi njëzëri dhe e përfshiu në listën e monumenteve “Trashëgimisë Kulturore Botërore”.

Sot, qyteti i Gjirokastrës është një pikë turistike kombëtare, periferike dhe ndërkombëtare, me arkitekturë karakteristike të ndërtesave dhe një shumicë monumentesh. Veçanërisht, shtëpitë janë të larta deri në pesë dysheme, të ndërtuara dhe shumë nga ato të rinovuara, nga gurë, me çati të mbuluar me pllaka të gdhendura guri dhe shkallë të brendshme dhe të jashtme, që rrethojnë banesën. Dyshemeja më e ulët e ndërtesës përfshin stallën dhe dyshemeja tjetër mbi të përbëhet nga një dhomë mikpritjesh dhe një dhomë për familjen me oxhak. Dyshemetë e sipërme janë për familje me shumë persona dhe lidhen me shkallë të brendshme.

Krahas arkitekturës së veçantë të qytetit dhe emërtesës “Qyteti i Gurtë”, identifikohen dhe shumë monumente të rëndësishme si Kështjella e qytetit, e njohur si Kalaja e Gjirokastrës, e cila është e njohur si monument kulture. Kalaja u ndërtua në shekullin e 13të dhe ndodhet në një pozicion strategjik mbi qytet. Ajo kontrollon rrugën strategjike të rëndësishme në gjatësinë e luginës së lumit Drino dhe është një nga kështjellat më të mëdha të Ballkanit. Brenda kalasë ekzistojnë dhe shumë pika interesi.

Në qytetin e Gjirokastrës identifikohen dhe shumë ndërtesa të karakterit fetar, si Kishat Ortodokse. Kisha më e rëndësishme është ajo e Shpërhytyrimit që gjendet në zonën e pazarit të vjetër Otoman dhe është monument. Kisha u ndërtua në vitin 1784 dhe përbën një kishë tipike ortodokse në formë katrore, drejtim të Shenjtorit drejt Lindjes dhe kubene.

Një tjetër ndërtesë e veçantë me karakter fetar që gjendet në qytetin e Gjirokastrës, por që nuk është shpallur monument është xhamia e vetme që nuk u shkatërrua gjatë periudhës së regjimit komunist. Gjendet në pazarin e vjetër Otoman dhe u ndërtua në vitin 1754. Ka një ndërtesë tetëkëndëshe në pjesën perëndimore që përdoret për larjen rituale të duarve dhe këmbëve para hyrjes së besimtarëve dhe salla e madhe në brendësi të portës kryesore përdoret për falje.

Në Gjirokastrë ekzistojnë dhe shumë ndërtesa monumentale që tashmë funksionojnë si hapësira muzeale si banesa Zekate (Hatif Zeko) dhe Angonatët, të mbrojtura si monumente nga Ministria e Kulturës. Veçanërisht, banesa e Zekatëve përbën një shembull madhor arkitektonik enjohur si shtëpi-kullë, të cilat i përkisnin kryesisht pronarëve të pasur dhe shpesh kishin frëngji për mbrojtjen ndaj armiqve. Ajo u ndërtua më 1811-1812, ka dy kulla paralele dhe një front harkor të dyfishtë.

5.4. MJEDISI FIZIK

5.4.1. Klima

Dallohen katër zona klimaterike në territorin e Shqipërisë: Mesdhetare fushore, Mesdhetare kodrinore, Mesdhetare paramalore dhe Mesdhetare malore. Veçanërisht Bashkia e Gjirokastrës karakterizohet si mesdhetare kodrinore juglindore.




Figura 16- Harta me zonat dhe nënzonat klimatike e Shqipërisë
(Burimi : Banka Botërore dhe UNDP, 2012)

Temperaturat. Në zonën e poshtme hidrografike të basenit të lumit Vjosë, d.m.th. deri në 500m mbi nivelin e detit, temperatura mesatare vjetor është 12-14°C. Mund të përmendet edhe temperaturat e Korrikut 20-24°C dhe ato të Janarit 4-6°C. Temperaturat mestare vjetore në zonat malore arrijnë deri në 8-10°C, ku dallohen ato të korrikut me 20°C dhe të Janarit 1-2°C. Temperaturat mestare vjetore variojnë nga 12.4°C në Gllavë deri në 14.1°C në Këlcyrë, 15.7°C në Përmet, 14.4°C në Gjirokastrë. 7.8°C në Çajup. Rreth 200 metra mbi nivelin e detit këto temperatura janë shumë të ulëta, deri në 6°C.

Temperaturat maksimale janë shumë ekstreme: këtu janë regjistruar temperaturat 41°C në Tepelenë, 42.2°C në Gjirokastrë dhe -13.1°C në Përmet. Edhe sasia e shirave ulet nga perëndimi në lindje. Sasia më e madhe e shiut bie në Kurvelesh (Tepelenë) 2'406mm, 1'275 në Përmet dhe 2'100mm në Gjirokastrë.

Rreshjet. Vargmalet përgjatë të dy brigjeve të Drinos dhe Vjosës mbledhin sasira të mëdha shirash që arrijnë mbi 2'800mm duke i ushqyer këta dy lumenj me ujë të bollshëm. Shtresa e borës është një tjetër burim që e ushqen lumin Vjosë dhe degët e tij gjatë dimrit në rastet e cikolene jugorë. Të cilët sjellin masa të nxehta nga vendet e ekuatorit dhe gjatë pranverës, kur temperatura e ajrit fillon të rritet.

5.4.2. Cilësia dhe Pastërtia e Ajrit

Në zonën e bashkisë Gjirokastër nuk vërehet ndotje e ajrit, edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare të cilat të bazohen në kërkime dhe informacione zyrtare. Theksohet se problemi më i thellë në rajonin më të gjerë të qytetit të Gjirokastrës, për shkak të pranisë së industrisë, aktiviteteve njerëzore më të mëdha dhe numrit më të madh të makinave dhe makinerive përgjatë gjatësisë së rrugëve dhe rrugicave të cilat kryesisht nuk janë të mirëmbajtura siç duhet. Në zonën tjetër të Bashkisë nuk është i dukshëm problemi sepse ekzistojnë kryesisht zona malore, pyjore dhe bujqësore pa burime kryesore ndotjeje mjedisore.

Për emetimet e gazrave nuk ka të dhëna analitike për shkak të mungesës së stacionit të regjistrimit. Megjithatë vlerësohet se përgjatë aksit rrugor SH4 si dhe përreth qytetit ushtrohet presion i vazhdueshëm, duke qenë se në këtë zonë përqendrohen burimet kryesore (trafik i ngarkuar, industri, banesa etj.). Djegia e drurit për ngrohje përbën një faktor tjetër të ndotjes nëpërmjet emetimit të mikrogrimcave, por pa qenë i mundur një vlerësim i plotë i ndikimeve. Prandaj, është i nevojshëm monitorimi i ndotjes së ajrit. Në pjesën perëndimore të Bashkisë janë mjaft të kufizuara për shkak të numrit të vogël të popullsisë, konsumit të ulët të energjisë shtëpiake dhe të ngarkesës së qarkullimit dhe aktiviteteve profesionale të kufizuara.

Njësia administrative	Popullsia e përgjithshme 2011	Emetimet e CO ₂ në ton metrik
Antigonë	998	1,606.78
Cepo	1,727	2,780.47
Gjirokastër	19,836	31,935.96
Lazarat	2,801	4,509.61
Lunxhëri	1,941	3,125.01
Odrie	433	697.13
Picar	937	1,508.57

Tabela 5: Shpërndarja e emetimeve të dioksidit të karbonit për çdo njësi administrative në Bashkinë Gjirokastër (burimi: PPV Gjirokastër)

5.4.3. Ndikimi në cilësinë e ajrit gjatë fazës së zbatimit të projektit

Zbatimi i projektit lidhet kryesisht me gërmimet të materialit tokësor, betonime për krijimin e parkimit nëntokësor prej 3 katesh, spostime të dherave dhe materialeve inerte, punime guri përsa i përket mureve, shtrimit të shesheve dhe në fasada, punime finiture dhe gjelbërimi, pa lënë këtu edhe automjetet e rënda që do të qarkullojnë gjatë zbatimit që ngrenë edhe më shumë pluhur dhe emetojnë gazra të dëmshëm për shëndetin, etj. Sigurisht që ky vëllim punimesh do të sjellë ngritje të grimcave të pluhurit në zonën e projektit gjë që mund të ndikojë pak edhe në zonën e hotel Çajupit dhe atyre shtëpive apo ndërtesave që gjenden në afërsi të zonës së punimeve. Kjo ngritje grimcash pluhuri dhe tymi automjetesh do të keqësojë për pak kohë cilësinë e mirë të ajrit që mbizotëron në këtë pjesë të bashkisë.

Faktorët që ndikojnë në rritjen e sasisë së pluhurit në ajër janë të shumtë si kushtet e motit (era që e favorizon ndotjen, shiu ul përkohësisht ndotjen), grumbullimet e inerteve për punime të cilat për lehtësi të shfrytëzimit të tyre nga automjetet e punës nuk mbulohen.

5.4.4. Masat zbutëse/korrigjuese për ruajtjen e cilësisë së ajrit

Gjatë fazës së zbatimit të projektit me qëllim uljen e ndikimeve negative në cilësinë e ajrit të zonës përreth duhen të merren disa masa parandaluese me qëllim zbutjen e ndikimit. Masat që rekomandohen për shmangien e ndotjes së ajrit janë:

- Lagia në mënyrë të vazhdueshme e zonës mbartëse të pluhurit duke përdorur automjete çisternë që hedhin ujë me rrjedhje;
- Kufizimi i shpejtësisë së mjeteve në rrugë;
- Përdorimi i transportierëve të mbuluar;
- Lagia e gomave të automjeteve përpara se ato të dalin nga zona e ndërtimit apo kantieri;
- Grumbullimet e mbetjeve dhe inerteve të mbahen të mbuluara sidomos në ditët me erë të fortë dhe të vendosen në zona të mbrojtura nga era.

Tabela 6: Ndikimet dhe masat zbutëse/korrigjuese kryesore në drejtim të cilësisë së ajrit				
Faza	Burimi i ndikimit	Ndikimi	Shkalla e ndikimit	Masat zbutëse/korrigjuese
Zbatimi i projektit	1.Kushtet e motit 2.Grumbullimet e inerteve dhe dherave; 3.Përdorimi i transporuesve pa mbulesë ; 4.Qarkullimi i automjeteve	Rritet sasia e grimacave të pluhurit në zonën përreth si dhe ndotja nga emetimi i gazeve të automjeteve të rënda	I mesëm	1.Lagia e shpeshtë e rrugës; 2.Kufizim i shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve; 3.Gjetja e një pozicioni të mbrojtur për grumbullimet e inerteve dhe dherave.

Gjatë fazës së shfrytëzimit të projektit, rikthimi i gjendjes së trafikut në gjendjen para fillimit të zbatimit do të sjellë stabilizimin e qarkullimit të mjeteve dhe njerëzve, gjithçka do ti kthehet normalitetit brenda një kohe të shkurtër. Mbjellja e pemëve të reja do të sjellë sadopak uljen e ndotjes nga emetimet e automjeteve. Sidoqoftë ky ndikim varet mjaft nga cilësia e karburantit të përdorur, vjetërsia e automjeteve, bllokimet e trafikut, etj.

5.4.5. Ndryshimet e klimës

Konferenca e Parisit lidhur me ndryshimet klimaterike (Paris COP21-CMP11) e vuri theksin e saj në krijimin e kushteve për mosrritjen dhe kufizimin e temperaturës globale jo me më shumë se 2 gradë celsius. Në varësi të vlerave të faktorit klimaterik dhe të dhënave të siguruara nga studime të ndryshme lidhur me ecurinë në vite të këtyre vlerave mund të paraqiten disa skenarë për ndryshimet klimatike (modeli i ndjekur sipas MAGIÇ / SCENGEN; v. 5, 3, v 2).

Skenari bazuar në ecurinë e rritjes së temperaturave mesatare, jo vetëm në Shqipëri por edhe në mbarë globin, ndryshimet klimaterike të parashikuara do të sjellin një klimë më të ngrohtë në regjimin e temperaturës në zonat bregdetare shqiptare. Skenari bazuar në rreshjet mesatare në rënie të regjistruara në stacione të ndryshme meteorologjike tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me mesataren e regjistruar në vitin 1990 si dhe një rritje të përmbajtjeve si pasojë e rreshjeve të vrullshme. Duke përgjithësuar rezultatet rezulton se sasia e reshjeve vjetore mund të ulen me 8,5% deri në 2050; dhe deri në 18,1%

në 2100. Këto vlera do të sjellin ndryshime të konsiderueshme në klimën globale dhe për pasojë dhe atë shqiptare. Kombinimi i ndryshimeve të faktorëve klimaterikë do të sjellë disa pasoja të cilat janë të lidhura me :

Rritjen e temperaturave minimale ditore e shoqëruar kjo me thatësira të zgjatura;

Ngrohjen dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së sezoneve të ftohta e cila do të ulë nevojat për konsum energjie për përdorim ngrohje;

Parashikohet një rritje e numrit të ditëve me temperaturë mbi 35°C dhe me shira të rrëmbyeshëm do të sjellë përmbytje të zonave të ulta, pranë lumenjve dhe në bregdet kjo e fundit si pasojë edhe rritjes së nivelit të detit.

Gjithashtu ngrohja globale do sjellë rritjen e temperaturës së tokës duke modifikuar periudhat e rritjes së të mbjellave p.sh zgjatja e periudhës së rritjes së të mbjellave është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990 (shiko figurën 17 hartën e rritjes së temperaturës së tokës).

Pavarësisht se parashikimet na paralajmërojnë për rreshje të vrullshme dhe të shkurtra, sasia totale e rreshjeve parashikohet të reduktohet për pasojë burimet ujore do të reduktohen në njëkohë që kërkesa për ujë do të rritet (shiko figurën 18 për hartën e .

Ndryshimi i regjimit të rreshjeve do të sjellë ndryshime të cilësisë së ujërave në tërësi dhe atij të pijshëm në veçanti;

Sektori i turizmit është i ekspozuar në mënyrë direkte dhe indirekte ndaj këtyre ndryshimeve si pasojë e rritjes së nivelit të detit dhe acidifikimit të ujit të deteve. Po ashtu këto ndryshimet do të ndikojnë në biodiversitet duke dëmtuar eko dhe agro turizmin. Kjo do të sjellë sfida të reja për këtë sektor.

Projektuesit dhe zbatuesit e zonës në studim duhet të parashikojnë me kohë investime në infrastrukturë për të përballuar ndryshimet.




Figura 17- Projektimi në përqindje i ndryshimit të indeksit të deficitit ujor për 2030
(Burimi: Banka Botërore)

5.5. GJEOMORFOLOGJIA, GJEOLGJIA DHE TOKAT

5.5.1. Gjeomorfologjia dhe Gjeologjia

Malet e Shqipërisë, nga ana tektonike janë të ndara në dy ndarje kryesore gjeologjike, Albanidet e Brendshme dhe të Jashtme. Albanidet e Brendshme janë të dominuara nga luginat ofiolitike ndërsa Albanoidet e Jashtme janë të përbëra nga katër gjysëm-paralele zona me hedhje: Zona e Krasta-Cukali, Zona e Krujës, Zona Joniane dhe Zona e Sazanit. Zona e studimit pozicionohet brenda zonave të Jonit dhe Sazanit. Pjesa e bregdetit përbëhet nga rëra detare kuaternare dhe zhavorre terciare. Molaset janë të depozituara në Masat e Peri-Adriatik, të cilat kanë shtresa të vjetra me sedimente karboni. Këto përbëhen nga ranore, myshqe, shale and marle.

Nga ana gjeomorfologjike rajoni ka një morfologji mjaft të zhvilluar ku kanë ndikuar faktorë të ndryshëm të lidhur me zhvillimin gjeostruktural të trevave shqipëtare ku rolin kryesor e kanë luajtur fazat e ndryshme tektonike dhe neotektonike. Produkt i këtyre faktorëve janë format e larmishme strukturore që zhvillohen në rajon në formën e vargmaleve dhe luginave të thella midis tyre.

Sipas studimit të Shërbimi Gjeologjik Shqiptar “Gjeoresurset dhe Gjeorreziket në Qarket e Shqipërisë, Qarku i Gjirokastrës” (2014), territori i qarkut të Gjirokastrës shtrihet në një hapësirë me kontraste të mëdha përsa i përket morfologjisë së relievit. Bredna këtij territori gjenden kodra të buta deri mesatare, male me shpatë të pjerrëta deri të thikta, lugina lumore të formave të ndryshme që nga fusha të gjera deri në kanione. Gjatë vlerësimit të terrenit, në bazë të pjerrësisë së relievit qarku ndahet në 3 zona morfologjike: Njësia morfologjike fushore, kodrinore dhe malore.

Përsa i përket gjeologjisë në Bashkinë e Gjirokastrës lokalizohen formacionet e mëposhtme nga më të vjetrit tek më të rinjtë:

Formacioni Halogjen: Triasiku i poshtëm e i mesëm T1 – T2,

Formacioni Karbonatik: Triasiku i sipërm T3, Jurasiku i poshtëm, i mesëm e i sipërm J1, J2 e J3, Kretaku i poshtëm Cr1, Kretaku i sipërm Cr2, Paleogjeni Pg1, Eogjeni Pg2,

Formacioni Flishor: Oligogjeni i poshtëm Pg3¹, i mesëm e i sipërm Pg3², Pg3³, akuitaniani, burdigaliani, langiani,

Formacioni Mollasik: Seravaliani,

Formacioni i depozitimeve kuaternare: Plesistogjeni, Hologjeni.

5.5.2. Tokat

Sipas një studimi të vlerësimit të tokës fizike, i cili përfundoi në fund të viteve 1990, toka bujqësore ndahej në dhjetë kategori sipas nivelit të përshtatshmërisë së tyre. Kategoria e parë ishte më e mira, kurse e dhjeta më e keqja. Si rregull, nga perëndimi në lindje, cilësia e tokës ulet për shkak të klimës më të ashpër dhe rritjes së pjerrësisë dhe lartësisë.

Njësia Administrative Lazarat					
I	Lazarat	Kat.II 15%	Kat.III 25%	Kat.IV 30%	Kat.V 30%
Njësia Administrative Lazarat					
1	Asim Zeneli	Kat. III 30%	Kat. IV 20%	Kat. V 20%	Kat. VII 30%
2	Krine	Kat. III 10%	Kat. III 20%	Kat. VI 30%	Kat. VII 40%
3	Saraqinishte	Kat. IV 20%	Kat. VI 30%	Kat. VII - VIII 50%	
4	Arshi Lengo	Kat. II 40%	Kat. III 40%	Kat. IV 20%	

RAPORTI I VNM
Ndertimi i godines se parkimit dhe hapesirave mbeshtetese ne
Gjirokastr

Njësia Administrative Gjirokastr					
1	Gjirokastr ish Perimore	Kat. II 35%	Kat. III 40%	Kat. IV 25%	
2	Gjirokastr ish Frutore	Kat. IV 40%	Kat. V 40%	Kat. VI - VII 20%	
Njësia Administrative Picar					
1	Picar	Kat. III 20%	Kat. IV 30%	Kat. V 20%	Kat. VII - VIII 30%
2	Kolonje	Kat. III 20%	Kat. IV 30%	Kat. VI 30%	Kat. VIII 20%
3	Golem	Kat. IV 25%	Kat. VII 35%	Kat. VIII 40%	
4	Shtepz	Kat. III 20%	Kat. IV 30%	Kat. VII 50%	
5	Kaparjel	Kat. V 30%	Kat. VII - VIII 70%		
Njësia Administrative Odrie					
1	Andon Poci	Kat. III 30%	Kat. IV 20%	Kat. VI 30%	Kat. VII 20%
2	Hundekuq	Kat. III 25%	Kat. IV 25%	Kat. VI 40%	Kat. VIII 10%
3	Terbuq	Kat. III 10%	Kat. IV 20%	Kat. VII 30%	Kat. VIII 40%
4	Labove e Madhe	Kat. III 10%	Kat. IV 30%	Kat. VI 30%	Kat. VIII 30%
5	Labove e Vogel	Kat. III 10%	Kat. V 30%	Kat. VI 30%	Kat. VII 30%
Njësia Administrative Lunxheri					
1	Valare	Kat. I 10%	Kat. II 50%	Kat. III 30%	Kat. IV 10%
2	Karjan	Kat. III 30%	Kat. V 20%	Kat. VI 20%	Kat. VII 30%
3	Gjati	Kat. II 20%	Kat. IV 30%	Kat. V 30%	Kat. VII 20%
4	Erind	Kat. III 20%	Kat. V 30%	Kat. VI 20%	Kat. VII 30%
5	Nokove	Kat. II 15%	Kat. III 25%	Kat. IV 25%	Kat. VII 35%
6	Mingul	Kat. II 10%	Kat. IV 30%	Kat. V 30%	Kat. VI - VII 30%
7	Kellez	Kat. III 20%	Kat. V 30%	Kat. VI 30%	Kat. VII 20%
8	Dhoksat	Kat. III 25%	Kat. IV 20%	Kat. V 30%	Kat. VII - VIII 25%
9	Qestorat	Kat. IV 30%	Kat. V 20%	Kat. VI 20%	Kat. VII - VIII 30%
10	Kakoz	Kat. III 30%	Kat. V 25%	Kat. VI 20%	Kat. VII - VIII 25%
Njësia Administrative Cepo					
1	Mashkullore	Kat. V 30%	Kat. VI 40%	Kat. VII 30%	
2	Cepune	Kat. IV 20%	Kat. III 20%	Kat. V 40%	Kat. VI 20%
3	Palokastra	Kat. IV 30%	Kat. III 20%	Kat. VI 20%	Kat. VII 30%
4	Koder	Kat. III 30%	Kat. V 30%	Kat. VI 40%	
5	Plesat	Kat. III 30%	Kat. IV 20%	Kat. VI - VII 50%	
6	Prongji	Kat. III 20%	Kat. IV 40%	Kat. VI - VII - VIII 40%	
7	Kardhiq	Kat. III 25%	Kat. V 35%	Kat. VII - VIII 40%	
8	Taronine	Kat. III 10%	Kat. VI 40%	Kat. VII - VIII 50%	
9	Fushe-Bardhe	Kat. IV 20%	Kat. V 20%	Kat. VIII 60%	
10	Zhulat	Kat. III 10%	Kat. IV 20%	Kat. VI - VII - VIII 70%	
11	Humelice	Kat. II 20%	Kat. III 30%	Kat. IV 30%	Kat. VII - VIII 20%

Tabela 7: Klasifikimi i tokës bujqësore në bazë të VKM nr. 703 datë 1995/12/18 dhe Direktiva e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit nr.1, datë 1995/12/29

5.5.3. Ndikimi gjatë fazës së zbatimit të projektit, dherat dhe masat zbutëse/korrigjuese

Trajtimi i materialeve të gërmuara. Gjatë fazës së zbatimit të projektit, (toka përreth është e një kategorie III) dhe si pasojë e punimeve dhe gërmimeve do të grumbullohen dhera, gurë dhe mbetje inerte. Këto materiale si pasojë e rreshjeve mund të përfundojnë në kanale, anash rrugëve dhe mbase një pjesë e tyre mund të përfundojnë dhe pranë Shtëpisë së Pioneerëve meqë ndodhet shumë pranë zonës së punimeve dhe nga niveli i poshtëm.

Sigurisht që terreni i thyer nuk e favorizon përhapjen e tyre dhe për rrjedhojë ndotjen e tokës përreth por sidoqoftë menaxhimi i tyre, rishfrytëzimi i tyre për ndërtim apo për mbyshje të tokës në zonë do të shmangte depozitimet e tyre dhe ndotja nga efekti i motit do të minimizohej. Rrezik për ndotje jo vetëm të tokës por edhe të ujërave nëntokësore mund të vijë nga përdorimi i pakujdesshëm i kompanisë zbatuese i vajrave, karburanteve etj.

Tabela 8: Ndikimet dhe masat zbutëse për gjeologjinë dhe dherat				
Veprimtaria	Burimi i ndikimit	Ndikimi	Shkalla e ndikimit	Masat zbutëse/korrigjuese
Ri-shfrytëzimi i dherave	Gërmimi për ndërtimin e kateve nëntokë	1. Bllokimi i kanaleve kulluese nga dherat që dalin nga gërmimet	E mesme	1. Dherat duhet të përdoren për rimbushje 2. Të transportohen të mbuluar në vendin e paracaktuar.

Ndikimi pas përfundimit të projektit dhe masat zbutëse/korrigjuese. Pas përfundimit të projektit do të kemi një stabilizim të mëtijshëm të dherave të kodrës dhe zonës përreth parcelës duke rritur qëndrueshmërinë e tyre për shkak të ndërtimit të objektit.

5.6. HIDROLOGJIA, UJRAT NËNTOKËSORE, SIPËRFAQËSORE DHE TRUPAT UJORE

5.6.1. Hidrologjia

Burimet e Ujit. Sipas Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, Drino është dega më e madhe e rrjetit hidrografik të lumit Vjosa. Lumi Drino ka një gjatësi rreth 85km dhe buron jashtë kufijve të Shqipërisë, në Greqi. Ai futet në vendin tonë midis Radatit dhe Kakavies dhe më pas kalon në ultësirën që shtrihet ndërmjet strukturave të Malit të Gjerë-Shtugarës dhe Lunxhëri-Buretos. Lumi Drino në gjithë fushën e Dropullit ka shtrat të gjerë, por në Hendëkuq ai rrjedh nëpër një grykë të thellë e të ngushtë deri sa derdhet në Vjosë, në rënë e Leklit. Prurja mesatare shumëvjeçare e lumit Drino me rrjedhje në Vjosë është 42.5 m³/s.

Ujrat Nëntokësorë. Qarku Gjirokastrë është i njohur për resurse të shumta dinamike të ujërave nëntokësore. Akuiferët karstikë dhe ato ndërkokrrizor vlerësohen me ujëmbajtje shumë të lartë, dhe paraqesin rëndësi të madhe në furnizimin e qendrave të mëdha të banuara me ujë të pijshëm.

Nga burimet karstike furnizohen qyteti i Gjirokastrës e shumë komunitete të tjera. Nga akuiferët kuaternarë furnizohet me ujë pjesërisht qyteti i Gjirokastrës e komunitete të

tjera. Në këto akuiferë janë kryer një numër i madh shpimesh “ilegale” që shfrytëzohen nga persona privatë për furnizim me ujë të pijshëm e në bujqësi për vaditje, sasitë e të cilave nuk janë të evidentuara.

5.6.2. Ndikimet gjatë fazës së zbatimit të projektit për hidrologjinë

Ujrat nëntokësore. Duhet bërë kujdes nga përdorimi i mjeteve të rënda të punës, impiantet e ndryshme si dhe i automjeteve të transportit, edhe pse mundësia për ndotjen e ujrave nëntokësore është e vogël, kryesisht nga ngritja e pluhurave dhe nga germimi i një thelësie të madhe toke. Kontrolli i shpeshtë nga ana e autoriteteve përgjegjëse dhe aplikimi i gjobave në përputhje me ligjin do të sigurojë një ruajtje të mjedisit.

5.6.3. Masat zbutëse/korrigjuese për ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore

Faza e zbatimit të projektit.

Materialet e ndërtimit, si betonet, vaji dhe kimikatet nuk do të grumbullohen dhe vendosen në afërsi me burimet ujore, apo në vende të hapura ku mund të rrëmbehen nga rrëke uji që mund të krijohen nga rreshjet.

Largimet e ujrave të ndotura të shkaktuara nga aktivitetet e kantierit do të trajtohen sipas rastit dhe në përputhje me llojin e tyre. Kështu uji i cili vjen nga larja e makinave dhe e pajisjeve të punës, do të trajtohet me metodën e sedimentimit për të bërë të mundur eliminimin e vajrave dhe grimcave ndërsa uji që vjen nga larja e agregateve dhe nga prodhimi i konglomerateve do të trajtohet me anë të sedimentimit në rezervuare dhe pastaj të përdoret përsëri ose të dërgohet në një vend tjetër. Mjafton që të tregohet kujdesi i nevojshëm, pasi rreziku për ndotjen e ujërave është i vogël.

Tabela 9: Ndikimet dhe masat zbutëse/korrigjuese për Hidrologjinë gjatë zbatimit të projektit

Elementi i Prekur	Burimet e ndikimit	Ndikimi	Shkalla e ndikimit	Masat zbutëse/korrigjuese
Ujërat nëntokësore	Ndotja nga rrjedhjet aksidentale të vajrave/karburanteve	Ndotje e ujrave nëntokësore	E ulët	1.Përdorimi i pajisjeve të reja dhe aplikimi i TMD me qëllim reduktimin e përhapjes së ndotjes; 2.Kryerja e furnizimeve në vendin e paracaktuar; 3. Zonat e parkimit të mjeteve dhe makinerive duhet të bëhen rezistente ndaj rrjedhjeve, ndërsa precipitimet duhet të trajtohen në separatorë para se të shkarkohen në tokë;

5.7. NDOTJA AKUSTIKE (ZHURMAT)

Në përputhje me VSM për PPK niveli i zhurmave urbane (LAeq): është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit aksusitk të ponderuar (A0), të prodhuar nga të gjitha burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.

Monitorimi tregon se Shqipëria qëndron afër vendeve të para në Evropë me parametra të lartë të ndotjes nga zhurma urbane. Si vlera mesatare të ditës ashtu edhe ato të natës e tejkalojnë standartin e legjislacionit të BE-së dhe atë shqiptar. Në veçanti, vlerat mesatare të zhurmës gjatë ditës dhe natës në qytetet e monitoruara janë përkatësisht LAeq

63dB (A) dhe LAeq 49.1dB (A). Të dy vlerat e tejkalojnë standartin e BE dhe atë shiptar (LAeq/Ditën 55dB (A) dhe LAeq/Natën 45dB (A)). Gjatë viti 2014, vlera mestarae e zhurmës si ditën dhe natën, ka qenë më e ulët krahasuar me vitin 2011 (monitorimi i fundit).

5.7.1. Ndikimet dhe masat zbutëse/korrigjuese ndaj zhurmëve

Faza e punimeve do të shoqërohet me një numër faktorësh të cilët do të ndikojnë në rritjen e ndotjes akustike. Së pari përdorimi i eskavatorëve, kamionëve, impianteve të betonit, transportit të dherave etj. Për këtë arsye pajisjet dhe makineritë që do përdoren në këtë aktivitet do plotësojnë direktivën 2000/1/14/CE të Parlamentit Evropian dhe të KE 8 maj 2000, do jenë të standartit të aplikueshëm në BE për zhurmat. Zbatimi i ligjit 9774, VKM (587/2010) dhe udhëzimit 8/2007 lidhur me monitorimin dhe kontrollin e zhurmave në qendrat urbane dhe turistike do të ndikonte në përmirësimin e mëtejshëm të situatës në zonën në studim.

Faza e shfrytëzimit do të shoqërohet me një rritje të vëllimit të trafikut të këmbësorëve si pasojë e hyrjes dhe daljes më të shpeshtë në parkimin nëntokësor së automjeteve të turistëve dhe banorëve apo personave që punojnë në zonën përreth.

5.8. RREZIQET NATYRORE

5.8.1. Sizmiciteti

Bashkia e Gjirokastrës ndodhet në zonën e Bregdetit Ionian (Ionian Coast - IC). Siç është referuar në studimin “seismicity, seismotectonics and seismic hazard assessment in Albania” (Aliaj et al. 2010) Bregdeti Ionian është një zonë që përmban pre-Pliogjen duke ushtruar komprimim të mirëfillt të zonave të prekuara të cilat janë shpëputur nga goditje-rëshqitje. Kjo zonë e prekur është akoma aktive dhe sizmiogjenike.

Istituto Nazionale di Geofisica e Vulcanologia Database of Individual Seismogenic Sources DISS version 3							
Seismicity parameters of Albania							
Table 1. Parameters for the ten seismic source zones							
Zone Name / Code	Zone Area (km ²)	Earthquakes used	Beta	Alpha (No)	M _a	Rate of M>6 p.a.	Rate density
Ohrid-Korça, KO	2760	44	1.44	242	6.9	0.0315	11.4
Kukes-Peshkopia, KP	1480	21	1.75	481	6.9	0.0104	7.0
Ionian Coast, IC	16600	151	1.40	692	7.0	0.115	6.9
Elbasan-Dibra-Tetova, EDT	2660	46	1.99	3142	6.9	0.0167	6.3
Periadriatic Lowland, PL	7460	75	1.61	914	7.0	0.0458	6.1
Lezha-Ukërinë, LU	5140	39	1.52	293	7.2	0.0272	5.3
Skopje, SK	3300	5	2.08	2541	7.2	0.00913	2.8
Shkëdra-Tropoja, ST	1570	11	1.99	778	6.9	0.00418	2.7
Peja-Prizreni, PP	1740	5	2.03F	418	6.8	0.00173	1.0
Eastern Albanian Backg. EAB	57200	75	2.03F	6075	6.5	0.0199	0.35

Notes: Skopje values adopted from [22]. "Rate density" is 10⁶ times annual rate for M≥6 per km². F=slope fixed as discussed in text.

Tabela 10: Tabela e listave të parametrave të dhjetë zonave të burimeve sizmike të Shqipërisë. (burimi: DISS)

5.8.2. Rrëshqitjet e dherave dhe përmytjet

Një nga problemet kryesore me të cilat përballlet zona është erozioni i tokës, i cili shkaktohet si nga faktorë natyrorë, klimatik dhe nga aktivitetet njerëzore. Shpejtësia më e lartë e erës që i ushtrohet tokës, si dhe stuhitë e shumta, më të forta dhe më të zgjatura në kohë, në kombinim me temperatura të larta ndikojnë në degradimin e tokës. Përsa i përket aktiviteteve njerëzore, urbanizimi dhe degradimi i tokave të punueshme, por edhe ekzistenca e industrisë pranë qytetit kontribuojnë në thellimin e problemit. Gjithashtu shpyllëzimi i tokës së punueshme në dia sektorë gjatë ndërtimit të infrastrukturave, përdorimi pa kriter i pesticideve dhe barnave të bimëve në kultivimet gjithnjë e në rritje si dhe blegtoia në rritje në këtë zonë kontribuojnë në erozionin e tokës dhe më tej në degradimin e biodiversitetit. Rezultat i erozionit të tokës janë përmytjet, të cilat në zonat e bashkisë ndodhin kryesisht në muajt e dimrit, përgjatë lumit Drino në luginën me të njëjtin emër, duke shkatërruar kultivimet dhe punët ndërtuese.

Sistemi i lumit paraqet rrezikun më të lartë të përmytjeve në vend. Përmytjet në përgjithësi janë me origjinë lumore dhe ndodhin në periudhën Nëntor-Mars kur vendi merr rreth 80-85% të rreshjeve vjetore. Për shkak të modeleve topografike, përmytjet ndodhin papritur, duke u transportuar përmes rrjetit lumit hidrografik kryesor për rreth 8-10 orë.

5.9. MJEDISI BIOLOGJIK

Zona e Bashkisë Gjirokastrë ka një mjedis tokësor të pasur në florë dhe faunë, si dhe ka një shumëllojshmëri të madhe të habitateve, e shoqëruar me një bimësi të një rëndësie të veçantë kombëtare.

5.9.1. Flora dhe fauna

Për sa i përket florës së Bashkisë, ajo karakterizohet si e pasur dhe e larmishme dhe ndahet në 4 zona fitoklimatike. Në zonat me lartësi të ulët janë të vendosura zonat me zhavorr të cilat kryesisht mbulojnë zonat fushore dhe rripat të cilat janë të mbuluara nga lisat, ekzistojnë kryesisht në zonat gjysmë malore dhe malore dhe përbëjnë brezin më të rëndësishëm fitoklimatik të zonës. Gjithashtu, rripi i tretë fitoklimatik është ai i bredhit mesdhetar dhe është i mbuluar nga pemë halore si pisha, bredh dhe bredhi dhe ndodhet në një lartësi prej 1000-1800m. Brezi i katërt është ai alpin i cili zhvillohet në një lartësi prej 1700-2400m dhe bimësia e tij karakterizohet kryesisht nga kullota të pasura. Por e rëndësishme është tërësia e luleve dhe bimëve farmaceutike dhe terapeutike që ndodhen në këtë zonë dhe kryesisht në zonën malore të Malit të Gjerë, shumë prej të cilave janë shumë të pëlqyera nga popullata lokale dhe kanë traditë shumëvjeçare në mbledhjen e tyre, të dyja për përdorim personal dhe familjar ose për shitje. Për më tepër, përgjatë lumit Drino dhe përrenjve, bimësia ujore zhvillohet kryesisht e përbërë nga shelgje, qershi cornelian dhe murriz, ndërsa në shtratin e lumit Drino kultivime të lokalizuara shumëvjeçare si fruta dhe kultivime vjetore si gruri.

Fauna e zonës është e larmishme. Për shkak të ekzistencës së vëllimeve malore dhe hapësirave pyjore, gjenden gjitarë të mëdhenj si ariu i murrmë, dreri, macet e egra, një larmi zogjsh dhe zvarranikësh. Në zonat gjysmë malore dhe ultësira, përveç deleve dhe dhive, ndodhen edhe gjitarë të vegjël si lepuijt dhe ketrat. Në fund të fundit, bimësia pranë lumenjve, në kombinim me zonat e kultivuara dhe kullotat, sigurojnë kushte mbijetese për shumë insekte, shumë zogj dhe peshq të tillë si ngjala dhe trofta.

Nuk ka specie të rrezikuara ose të mbrojtura të florës dhe faunës në vendin e projektit, pasi ajo është një zonë shumë e urbanizuar dhe e banuar. Nuk parashikohet ndonjë ndikim i madh në pemët në zonën e punimeve. Vetëm pemët që janë në trotuarin pranë murit midis dy shesheve do të zhvendosen për shkak të ndërtimit të gurit të ri të konceptuar.

5.9.2. Ndikimi mbi florën, faunën dhe biodiversitetin

Në zonën në studim bie në sy një shumëllojshmëri peisazhi i cili shoqërohet nga një shumëllojshmëri biodiversiteti faunistik dhe floristik. Periudha relativisht e gjatë e punimeve 24 muaj me të gjithë faktorët e saj (zhurmat, mbetjet, gërmimet, betonimet etj) krijon kushte për efekte negative kumulative në zonë. Shmangia e tyre kërkon marrjen e një sërë masash zbutëse dhe korrigjuese. Përgjithësisht duhet të shmanget dëmtimi i habitateve/specieve të rralla dhe të rrezikuara. Gjatë ndërtimit të përcaktohen rrugët e lëvizjes me qëllim minimizimin e shkatërrimit të habitatit. Të respektohen rregulloret dhe procedurat përkatëse për mbrojtjen nga zjarri. Gjatë ndërtimit shmang dëmtimin e pemëve dhe rrënjët e tyre. Të merren masat për të parandaluar rrëshqitjet e tokës.

6. MONITORIMI

Monitorimi është procesi i zbulimit të ndryshimeve, nëse ato do të ndodhin, i përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes të tyre. Objektivat kryesorë të monitorimit janë:

- Për të identifikuar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të ndotjes së tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjedisit ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor me synimin për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.

Kontrolli i ndikimeve mjedisore

Kontrolli i ndikimeve mjedisore përfshin:

- kontrollin sistematik, ditë për ditë, për të gjitha aktivitetet bazë të ndërtimit,
- krijimin e lehtësirave në sipërfaqet ku punohet,
- pastrimi i vendit ku punohet.

Parametrat që do të monitorohen janë:

- Niveli i ndotjes së ujërave që përshkojnë rajonin Matja e BDO5;
- Matja e KDO në vendet e shkarkimeve të ujërave në të;
- Identifikimi i prezencës së elementeve kimik të rrezikshëm.

Sasia në masë dhe vëllim të mbeturinave mujore:

- Mbetje shtëpiake;
- Letër;
- Plastikë.

Sasia e energjisë së harxhuar për muaj:

- Energji elektrike;
- Sasia e karburantit të gjeneratorit;
- Sasia e karburantit të përdorur nga makinat dhe makineritë.

Sasia e ujit e konsumuar për muaj:

- Ujë teknologjik për proceset e ndërtimit;
- Ujë për konsum për punonjësit.

Niveli i ndotësve në ajrin e mjediseve të brendshme:

- PM10
- PM2.5
- Pluhur total

Niveli i ndotjes së zhurmave:

- Në ambiente publike;
- Në orët e natës dhe të ditës, etj.,

Monitorimet do të kryhen nga vetë investitori (mbikqyrësi) dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse. Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundërt sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo 3 muaj të dorëzohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me fotografi.

7. REKOMANDIME TE PERGJITHSHME

7.2. REKOMANDIME PER TOKEN DHE SIZMICITETIN

Gjatë fazës së zbatimit të projektit, dhe si pasojë e punimeve dhe gjurmimeve do të grumbullohen dhera, gurë dhe mbetje inerte. Këto materiale si pasojë e rreshjeve mund të përfundojnë në kanale, anash rrugëve dhe mbase një pjesë e tyre mund të shkojnë drejt banesave në lagjet poshtë për shkak të pjerrësisë së terrenit. Shmangia e ndotjes nga këto materiale duhet të bëhet përmes grumbullimit (zona depozitimi) të tyre në zona të mbrojtura nga era apo rrjedha e shirave. Sigurisht që terreni i thyer nuk e favorizon përhapjen e tyre dhe për rrjedhojë ndotjen e tokës përreth por sidoqoftë menaxhimi i tyre, rishfrytëzimi i tyre për ndërtim apo për mbyshje të tokës në zonë do të shmangte depozitimet e tyre dhe ndotja nga efekti i motit do të minimizohej.

Bazuar në të dhënat e trajtuara në kapitullin sizmicitetit, një kujdes i veçantë i duhet kushtuar ndërtimeve në rajon si për ndërtime me karakter turistik ashtu edhe ato me karakter industrial për të shmangur incidente që mund të çojnë në katastrofa njerëzore dhe ekologjike.

7.3. REKOMANDIME PËR RUAJTJEN E CILËSISË SË AJRIT

Gjatë fazës së zbatimit të projektit me qëllim uljen e ndikimeve negative në cilësinë e ajrit të zonës përreth duhen të merren disa masa parandaluese me qëllim zbutjen e ndikimit. Masat që rekomandohen për shmangien e ndotjes së ajrit janë: lagia në mënyrë

të vazhdueshme e zonës mbartëse të pluhurit duke përdorur automjete çisternë që hedhin ujë me rrjedhje; kufizimi i shpejtësisë së mjeteve në rrugë; përdorimi i transportierëve të mbuluar; lagia e gomave të automjeteve përpara se ato të dalin nga zona e ndërtimit apo kantieri; grumbullimet e mbetjeve dhe inerteve të mbahen të mbuluara sidomos në ditët me erë të fortë dhe të vendosen në zona të mbrojtura nga era nga dhe rrëketë e ujrave që mund të krijohen nga kushtet e motit.

7.4. REKOMANDIME PËR UJËRAT SIPËRFAQËSORE/NËNTOKËSORE

Ruajtja e materialeve që do të përdoren gjatë fazës së zbatimit të projektit do të bëhet në zona të mbrojtura nga rrjedhjet e ujërave të rreshjeve, të ujit të përdorur për qëllime ndërtimi apo zonave me puse apo me zona të njohura mbartëse të ujërave nëntokësore.

Ato duhet të ruhen në kioska provizore apo kontenierë dhe në rasti më të thjeshtë të mbulohen mirë. Kujdes duhet të bëhet në mënyrë të veçantë në zonat e përgatitjes së llaçit apo betonit të cilat duhet të përpunohen në hapësira të izoluara me tokën dhe të rrethuara nga bordura që nuk lejojnë rrjedhjen e ujërave të ndotura.

Ujërat që do të përdoren për larje automjeteve dhe pajisjesh pune duhet të trajtohen paraprakisht me një nga metodat e njohura si ajo sedimentimit në gropa të ndërtuara posaçërisht të cilat janë të izoluara me mure apo parete të padepërtueshme. Riciklimi i këtij vëllimi uji do të ishte një tjetër masë që duhet marrë.

7.5. REKOMANDIME NGA ZHURMAT

Zona në studim është një zonë që ka një numër të kufizuar të shtëpive të banimit por ka një numër të konsiderueshëm strukturash turistike.

Faza e zbatimi të projektit do të shoqërohet me një numër faktorësh të cilët do të ndikojnë në rritjen e ndotjes akustike. Së pari përdorimi i eskavatorëve, kamionëve, impianteve të betonit, etj. Për këtë arsye pajisjet dhe makineritë që do të përdoren në këtë aktivitet do plotësojnë direktivën 2000/1/14/CE të Parlamentit Evropian dhe e KE 8 maj 2000, do jenë të standartit të aplikueshëm në BE për zhurmat. Zbatimi i ligjit 9774, VKM (587/2010) dhe udhëzimit 8/2007 lidhur me monitorimin dhe kontrollin e zhurmave në qendrat urbane dhe turistike do të ndikonte në përmirësimin e mëtejshëm të situatës në zonën në studim. Përcaktimi i një orari të përshtatshëm të kryerjes së punimeve do ishin masa që do të zbusnin ndikimin negativ të ndotjes së zhurmave.

7.6. REKOMANDIME NGA MBETJET

Mbetjet e gjeneruara nga gërmimet e mundshme, nga materialet e ndërtimit paraqesin një shkallë rreziku të vogël për ndotjen në tërësi të mjedisit në zonën e zbatimit të projektit. Gjithsesi nevoja e hartimit të një plani menaxhimi për evakuimin e tyre nga zona paraqitet i domosdoshëm pasi jo i tërë materiali i gërmuar dhe materialet e transportuara në kantier do të mund të riciklohen. Distanca relativisht e largët e vend-depozitimit dhe mungesa e faciliteteve për menaxhim të përshtatshëm të mbetjeve pranë zonës së projektit mund të lindin nevojën e krijimit të një vendi depozitimi të përkohshëm në përputhje me rregulloret, në bashkëpunim me pushtetin vendor. Në fund të punimeve supervizori duhet të kontrollojë zonën e zbatimit të projektit dhe atë në afërsi të saj për grumbullime të rastësishme apo të qëllimshme të mbetjeve të të gjitha llojeve.

8. BIBLIOGRAFIA

- Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015
Këshilli i Ministrave, Vendim 88 i 1993, "Për Miratimin e Zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit".
- Kolegjit Imperial të Londrës (2005), Lidhja ndërmjet direktivave të VNM dhe VSM. Raporti përfundimtar për Komisionin Evropian.
- Komisioni Evropian, DG Mjedis (2003), Implementimi i Direktivës 2001/42 mbi vlerësimin e efekteve të planeve të caktuara dhe programeve për mjedisin.
- Morris, Peter dhe Therivel, Riki (botuar) (2009), "Metodat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Vëllimi III.
- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit "Draftstrategjia Kombëtare për Turizmin 2014-2020"
- PPV e Bashkisë Gjirokastrë me gjithë dokumentat përkatëse shoqëruese.
- Dokumenta të sugjeruara nga Projektuesi.
- Qeveria e Shqipërisë Ligji nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".
- Qeveria e Shqipërisë Ligji nr.10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit"
- Qeveria e Shqipërisë Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura".
- Qeveria e Shqipërisë VKM Nr. 912, datë 11.11.2015 "Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis";
- Qeveria e Shqipërisë VKM Nr.13, datë 4.1.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis"
- Qeveria e Shqipërisë Udhëzim nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë "Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".
- Qeveria e Shqipërisë Udhëzim nr.6527 datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre"
- Qeveria e Shqipërisë VKM nr. 177, date 31.03.2005 " Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse";
- Qeveria e Shqipërisë. Ligj Nr.9244, date 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqesore"
- Qeveria e Shqipërisë. Ligji nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar"
- Qeveria e Shqipërisë. Ligj Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"
- Qeveria e Shqipërisë. Ligji 8906 i 2002, "Për Zonat e Mbrojtura" ndryshuar me ligjin 9868.
- Qeveria e Shqipërisë ligj për "Mbrojtjen e Mjedisit" nr. 10 431, datë 9.6.2011
- Qeveria e Shqipërisë. Ligji 9048 i 2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" ndryshuar Nr. 9882, datë 28.02.2008 .
- Qeveria e Shqipërisë. Ligji nr.107/2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- Qeveria e Shqipërisë. Ministria e Mjedisit, Draft-Strategjia Kombëtare Mjedisore (2015-2020).
- Qeveria e Shqipërisë. Ligj nr. 92/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar"
- Qeveria e Shqipërisë. Ligj nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Qeveria e Shqipërisë. VKM Nr. 587 datë 07.07. 2010 " Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike"